

1 E enjte, 7 tetor 2021

2 [Deklarata hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.34 paradite

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

7 Mirë se erdhët të gjithë.

8 Përpara se të fillojmë u jap mundësi fotografëve. Kërkoj
9 ndjesë. Po, mund të bëni fotografi. Faleminderit.

10 Me cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues numër II dhe në
11 pajtim me Rregullën 124(1) të Rregullores, e deklaroj të hapur
12 këtë gjykim dhe i kërkoj Sekretares të Gjykatës të paraqesë
13 lëndën.

14 Z. REES: [Mikrofoni nuk është aktivizuar].

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila kërkesë
16 më në veçanti? Me ç'qëllim?

17 Z. REES: [Mikrofoni nuk është aktivizuar].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është një
19 test, po nuk është problemi - nuk dëgjohet mikrofoni i
20 avokatit. Funksionon?

21 Z. Rees, e kuptova atë që thatë që kërkesa e Rregullës
22 117(2) në lidhje me dëshmitarët nuk ka marrë vendim akoma.
23 Tani po jap vendim gojarisht. E kemi shqyrtuar këtë çështje.
24 Kërkesa nuk pranohet. Arsyetimin do t'jua japim më pas.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani u lutem

1 palëve që të prezantohen duke filluar me Zyrën e Prokurorit të
2 Specializuar.

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni.

5 Ndaluam pa e paraqitur lëndën, Sekretarja.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar
7 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i
8 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Hardinajt.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Tani znj. Prokurore e keni fjalën të prezantoheni.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës,
12 mirëdita. Në emër të Prokurorisë së Specializuar, sot
13 paraqiten, Jack Smith, Prokurori i Specializuar, James Pace,
14 Ndhmës Prokuror, Matthew Halling, Ndhmës Prokuror, Line
15 Pedersen, Menaxhere e Lëndës dhe e Provave, ndërsa unë jam
16 Valeria Bolici, Prokurore pranë ZPS-së.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Tani i kthehem Mbrojtjes.

19 Z. Rees ju lutem.

20 Z. REES: [Përkthim] Quhem Jonathan Rees. Paraqitem në
21 emër të z. Gucati. Ndhmohem nga z. Hugh Bowden dhe znj.
22 Eleanor Stephenson, z. Remi Halilaj, znj. Faye Wigmore, dhe z.
23 Joseph Bowden.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Faleminderit.

25 Z. Cadman ju lutem.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Jam
2 Toby Cadman, Mbrojtës i Specializuar që paraqitem në emër të
3 z. Nasim Haradinaj, që është i pranishëm edhe këtu sot. Pra z.
4 Carl Buckley, z. Omar Solimon, znj. Poppy Henderson, dhe z.
5 Admir Berisha që ndodhen pas meje. Në krah kam znj. Miriam
6 Rosberg.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Faleminderit. Në emër të
8 Zyrës Administrative kush paraqitet?

9 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës. Në emër
10 të Zyrës Administrative ndodhet Administratorja znj. Fidelma
11 Donlon dhe unë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Faleminderit.

13 Përpara se të fillojmë dëshiroj që t'jua rikujtoj të
14 gjithëve disa rregulla që duhen respektuar gjithmonë për të
15 siguruar punime efektive dhe procesverbal të saktë.

16 Ju lutem përpara se të flisni sigurohuni të keni ndezur
17 mikrofonin dhe ta fikni me të mbaruar. Flisni ngadalë dhe
18 qartë sepse kemi përkthim drejt dhe prej gjuhëve shqipe dhe
19 serbishte. Në këtë mënyrë përkthyesit mund ta bëjnë punën e
20 tyre siç duhet. Përpara se të flisni prisni pesë minuta, pesë
21 sekonda - më falni, për t'u dhënë kohë përkthyesve të
22 mbarojnë përkthimin e fjalisë së fundit.

23 Dëshiroj t'ju rikujtoj se gjykimi zhvillohet në seancë të
24 hapur. Nëse nuk kërkohet ndryshe nga palët ose nuk vendoset
25 ndryshe nga Trupi Gjykses. Ju lutem informoni paraprakisht

1 nëse në një parashtrim përmban informacion konfidencial, në
2 mënyrë që të kalojmë në seancë private ose të mbyllur.

3 Ju rikujtoj të gjithëve të ndjekin procedurën e
4 redaktiveve në seancë të cilën e kemi përcaktuar në Urdhrin
5 për Zhvillimin e Procesit.

6 Seanca sot zhvillohet në bazë të Rregullave 124, 125 dhe
7 126 të Rregullores së Provave dhe Procedurës së Dhomave të
8 Specializuara.

9 Në fillim Prokurori i Specializuar do të lexojë
10 aktakuzën. Pastaj me cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykses do
11 t'i pyes të Akuzuarit nëse e kuptojnë aktakuzën dhe do t'u jap
12 mundësi të konfirmojnë dhe deklarimin e bërë fillimisht prej
13 tyre. Pastaj do t'i informoj të Akuzuarit për të drejtat dhe
14 detyrimet e tyre. Në fund do t'ia jap fjalën Prokurorit të
15 Specializuar të mbajë deklaratën hyrëse.

16 Përpara këtij hapi, do të jap disa udhëzime për
17 paraqitjen e provave në javët e ardhshme. Plani është që ta
18 përfundojmë seancën sot deri në orën 4 pasdite. Por nëse ZPS-
19 ja, nëse ZPS-së më falni i duhet më shumë kohë për ta
20 përfunduar deklaratën hyrëse mund ta zhvillojmë edhe një
21 sesion të parë nesër.

22 Përpara se të fillojmë do të bëj një përmbledhje të
23 historikut procedural të kësaj çështjeje gjyqësore.

24 Më datë 25 dhe 26 shtator 2020, Hysni Gucati dhe Nasim
25 Haradinaj u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin

1 e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë të
2 Holandës.

3 Më datë 20 tetor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti
4 për konfirmim përpara Gjykatësit të Procedurës Paraprake
5 aktakuzë kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj.

6 Më datë 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake
7 e konfirmoi pjesërisht aktakuzën dhe urdhëroi ZPS-në që të
8 paraqiste aktakuzë të rishikuar sipas konfirmimit.

9 Më datë 5 korrik 2021, sipas një vendimi të Panelit të
10 Gjykatës së Apelit, ZPS-ja protokolloi aktakuzë të korrigjuar.

11 Më datë 16 korrik, 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake
12 ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.

13 Më datë 8 shtator, 2021, Trupi Gjykues caktoi datën e
14 sotshme 7 tetor 2021 si datë të hapjes së çështjes gjyqësore,
15 dhe vendosi që paraqitja e provave nga ZPS-ja të fillojë më
16 datë 18 tetor 2021.

17 Tani do të vijojmë me leximin e aktakuzës siç e
18 parashikon Rregulla 124(2).

19 Z. Prokuror, ju lutem lexoni versionin e paredaktuar të
20 aktakuzës së korrigjuar siç është protokolluar më datë 5
21 korrik, 2021. Sipas nevojës do të kalojmë në seancë private
22 apo të mbyllur për të lexuar pjesët konfidenciale. Pas, si të
23 dalim nga seanca private, Prokurori do të lexojë versionin e
24 redaktuar të të njëjtit tekst.

25 Z. Prokurorit, keni fjalën.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: Të nderuar Gjykatës jemi rikthyer
7 në seancë publike.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Faleminderit.

9 Prokuror, mund të vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 Të Akuzuarit.

12 Hysni Gucati, emri i babait redaktuar, u lind më 30 mars
13 1967, në Morinë, Komuna e Skënderajt, Kosovë. Adresa e fundit
14 e njohur e tij është redaktuar Kosovë. Ai ka shtetësinë
15 kosovare. Numri personal redaktuar.

16 Nasim Haradinaj, emri i babait i redaktuar, u lind më 21
17 maj 1963 në Gllogjan, Komuna e Deçanit, Kosovë. Adresa e
18 fundit e njohur e tij është e redaktuar, Kosovë. Ka shtetësi
19 kosovare me numër personal, i redaktuar.

20 Në të gjitha periudhat që lidhen me këtë aktakuzë, Hysni
21 Gucati dhe Nasim Haradinaj, përkatësisht kanë qenë Kryetar dhe
22 Nën-Kryetar të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë
23 Çlirimtare të Kosovës, ndryshe OVL-UÇK.

24 Paraqitja e fakteve.

25 Të gjitha veprat penale të paraqitura në këtë aktakuzë,

1 kanë lidhje me procedurat zyrtare të Dhomave të Specializuara
2 dhe hetimit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ndryshe
3 ("ZPS"). Bashkërisht këto quhen "Procedurat e DHS-së".

4 Të gjitha referencat për dëshmitar ose dëshmitarë në këtë
5 aktakuzë duhet të kuptohen se përfshijnë të gjithë personat që
6 me gjasë kanë informacion për veprë penale kryer sipas
7 rrethanave të rëndësishme lidhur me procedurat e DHS-së.

8 Midis më së paku prillit dhe shtatorit 2020, Hysni Gucati
9 dhe Nasim Haradinaj bënë deklaratat akuzuese për dëshmitarët që
10 bashkëpunojnë me ZPS-në dhe për persona të tjerë duke i
11 quajtur ata ndër të tjera gënjeshtarë, bashkëpunëtorë, dhe
12 tradhtarë. Kjo sjellje tregon qartë synimin dhe motivin e tyre
13 për të dëmtuar dhe penguar procedurat e DHS-së.

14 Sikurse shtjellohet më poshtë midis 7 dhe 25 shtator
15 2020, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Faton Klinaku (Sekretar i
16 OVL-UÇK-së), Tomë Gashi (Avokat i OVL-UÇK-së) dhe anëtarë e
17 përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, bashkërisht me Faton
18 Klinaku në dhe Tomë Gashi të quajtur këtu "Ndihmësit"
19 shpërndanë pa autorizim informacion konfidencial dhe jopublik
20 në lidhje me hetimet konfidenciale të Task-Forcës Hetimore
21 Speciale, ndryshe të quajtur këtu 'TFHS' dhe të ZPS-së.
22 Inkurajuan të tjerë të shpërndajnë më tej informacioni
23 konfidencial dhe jopublik dhe ndërmorën veprime të tjera për
24 qëllimin e deklaruar të pengimit të punës së DHS-së apo ZPS-
25 së. Ky informacion konfidencial dhe jopublik përfshinte

1 dokumente të shënuara si konfidenciale dhe emra të dhënë -
2 personale të qindra dëshmitarëve të mbrojtur në kontekstin e
3 Procedurave të DHS-së dhe procedimeve penale të mëpasshme në
4 Kosovë ose në lidhje me Kosovën.

5 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj organizuan dhe
6 bashkërenduan së bashku me Ndihmësit shpërndarjen e
7 paautorizuar të informacionit konfidencial dhe jopublik dhe
8 veprime të tjera lidhur me të, ndër të tjera, përmes këqyrjes
9 së informacionit konfidencial dhe jopublik, pjesëmarrjes në
10 vendime nëse dhe si do të shpërndahej ai informacion dhe
11 organizimet e pjesëmarrjes në ngjarje në lidhje me të duke
12 përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike, në të
13 cilat u shpërnda dhe u diskutua publikisht informacion
14 konfidencial dhe jopublik.

15 Dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.

16 Më 7 shtator, 2020 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj,
17 përkatësisht në cilësinë e Kryetarit dhe Nën-Kryetarit të OVL-
18 UÇK-së zhvilluan një konferencë për shtyp, në të cilën Hysni
19 Gucati njoftoi se OVL-UÇK-janë kishte marrë dosje dokumentesh
20 në lidhje me DHS/ZPS-në, "Konferenca e Parë për Shtyp" e
21 quajtur këtu më tutje. Gjatë Konferencës së Parë për Shtyp,
22 këto dosje ishin ekspozuar mbi një tavolinë. Nasim Haradinaj
23 deklaroi se gjatë Konferencës së Parë për Shtyp do të viheshin
24 në dispozicion katër kopje dokumente. Ai përmendi emrat,
25 vendin e banimit, vendin e punës dhe të dhëna të tjera

1 personale të katër dëshmitarëve. Nasim Haradinaj shpjegoi
2 gjithashtu se dokumentet e nxjerra gjatë heurës së parë
3 përfshinin emra, adresa, numra telefoni, të dhëna të tjera,
4 deklarata dhe informacion në lidhje me dëshmitarë të tjerë të
5 intervistuar, ndër të tjera, shqiptarë, romë, dhe serbë. Nasim
6 Haradinaj pranoi se dokumentet ishin konfidenciale. Ai
7 deklaroi se OVL-UÇK-ja do tu dërgonte deputetëve të Kuvendit
8 të Kosovës kopje të dokumenteve dhe se të pranishmëve në
9 Konferencën e Parë për Shtyp do t'u jepte sa kopje të
10 dëshironin. Nasim Haradinaj u bëri thirrje të pranishmëve që
11 të merrnin kopje të dokumenteve dhe t'i shihnin emrat dhe
12 deklaratat e dëshmitarëve.

13 Më 7 shtator 2020, Gjykatësi i vetëm i DHS-së, autorizoi
14 sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të
15 nxjerra gjatë Heurës së Parë. Konfirmoi natyrën konfidenciale
16 dhe jopublike të HJFS-së dhe ZPS-së dhe urdhëroi që personat
17 të cilët posedonin dokumentet ose përmbajtjen e tyre të mos i
18 kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato. Ky është "Urdhri i
19 Parë".

20 Më 8 shtator 2020, ZPS-ja dorëzoi Urdhrin e Parë dhe
21 sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së. Materialet e
22 sekuestruara përfshinin informacion konfidencial dhe jopublik
23 në lidhje me hetimet konfidenciale, ndër të tjera,
24 identitetin, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve.

25 Pas Konferencës së Parë për Shtyp, midis 7 dhe 15

1 shtatorit 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj bënë
2 deklarata të shumta publike lidhur me dokumentet e nxjerra
3 gjatë Herës së Parë. Në kuadër të atyre deklaratave, Hysni
4 Gucati dhe Nasim Haradinaj publikisht:

5 i. konfirmuan se përfaqësuesve të shtypit u ishin dhënë
6 kopje të dokumenteve gjatë Herës së Parë;

7 ii. zbuluan më shumë nga përmbajtja e dokumenteve të
8 nxjerra gjatë Herës së Parë, duke përfshirë hetimeve
9 konfidenciale;

10 iii. deklaruan se në dokumentet përmendeshin me emër
11 dëshmitarë, si dhe përmendën datat dhe vendet e kryerjes së
12 disa intervistave;

13 iv. akuzuan dëshmitarët e përmendur në emër të
14 dokumenteve - në dokumente se ishin ndër të tjera gënjeshtarë,
15 tradhtarë dhe spiunë;

16 v. --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, z.
18 Prokuror, kemi ende probleme teknike. Nuk dëgjohet mikrofoni i
19 Avokatit.

20 Z. CADMAN: [E padëgjueshme].

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër,
22 duhet t'i kërkojmë dikujt që ta shikojë këtë. Po punojmë për
23 këtë gjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për t'i dhënë
25 zgjidhje kësaj, tekniku kërkon një pauzë të punimeve dhjetë

1 minuta, që kështu do të dalim.

2 Do të bëjmë një pauzë për dhjetë minuta. Por mos u
3 largoni shumë nga salla.

4 --- Pauza fillon në orën 9.58 paradite

5 --- Seanca rifillon në orën 10.08 paradite

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
7 ndjesë për ndërprerjen. Me sa duket ka një problem. Të kemi
8 kujdes me dokumentet që të mos pengojmë sistemin se jemi shumë
9 pranë njëri-tjetritin.

10 Mund të vazhdoni, zoti Prokuror.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Po e filloj nga
12 fillimi i paragrafit.

13 Pas Konferencës së Parë për Shtyp, nga 7 dhe 15 shtatori
14 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj bënë deklaratë të
15 shumta publike lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë Herës së
16 Parë. Në kuadër të këtyre deklaratave, Hysni Gucati dhe/ose
17 Nasim Haradinaj publikisht:

18 i. konfirmuan se përfaqësuesve të shtypit u ishin dhënë
19 kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë Herës së Parë;

20 ii. zbuluan më shumë nga përmbajtja e dokumenteve të
21 nxjerra gjatë Herës së Parë, duke përfshirë hollësitë e
22 hetimeve konfidenciale;

23 iii. deklaruan se në dokumentet përmendeshin me emër
24 dëshmitarë, si dhe përmendën datat dhe vendet e kryerjes së
25 disa intervistave;

1 iv. akuzuan dëshmitarët e përmendur me emër në
2 dokumente, se ishin ndër të tjera, gënjeshtarë, tradhtarë dhe
3 spiunë;

4 v. inkurajuan përfaqësues të shtypit të publikonin
5 dokumentet e përfshira në dokumentet e nxjerra në Herën e
6 Parë;

7 vi. deklaruan se nëse do të merrnin informacion
8 konfidencial dhe jopublik të mëtejme do ta shpërndanin
9 publikisht;

10 vii. dhe deklaruan se nuk e njihnin DHS/ZPS-në dhe se
11 veprimet e tyre kishin për qëllimin pengimin e DHS/ZPS-së.

12 Pas Konferencës së Parë për Shtyp dhe gjatë ditëve
13 në vijim, disa përfaqësues të shtypit dhe publikut shpërndanë
14 më tej në shtyp dhe në internet informata me emra dhe të dhëna
15 personale dëshmitarësh që përfshiheshin në dokumentet e
16 nxjerra gjatë Herës së Parë.

17 Dokumentet e nxjerra gjatë Herës së Dytë.

18 Më 16 shtator 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj,
19 përkatësisht në cilësinë e Kryetarit dhe Nën-Kryetarit të OVL-
20 UÇK-së mbajtën konferencë për shtyp, Konferenca e Dytë për
21 Shtyp, ku Hysni Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë një
22 paketë tjetër dokumentesh. Ai u tha të pranishmëve se mund t'i
23 merrnin dokumentet 'dokumentet e nxjerra gjatë Herës së Dytë'.
24 Ndërsa po tregonte dokumentet ai përmendi me emër dy persona
25 që kishin bashkëpunuar me TFHS-në.

1 Nasim Haradinaj përsëriti emrin e një personi që tashmë
2 ishte përmendur nga Hysni Gucati. Përmendi me emër një person
3 tjetër që kishte bashkëpunuar me TFHS-në dhe zbuloi
4 informacion konfidencial dhe jopublik të mëtejshëm lidhur me
5 hetimet konfidenciale. Nasim Haradinaj u tha të pranishmëve se
6 dokumentet ishin në dispozicion për të gjithë dhe u tha se
7 mund t'i merrnin ato.

8 Më 17 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm i DHS-ë autorizoi
9 sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të
10 nxjerra gjatë Herës së Dytë. Konfirmoi natyrën konfidenciale
11 dhe jopublike të informacionit nga hetimet e TFHS-së dhe ZPS-
12 së dhe urdhëroi që personat të cilët posedonin dokumentet ose
13 përmbajtjen e tyre të mos i kopjonin, incizonin apo t'i
14 shpërndanin ato. Urdhri i Dytë. Më vonë atë ditë ZPS-ja
15 dorëzoi Urdhrin e Dytë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet
16 e OVL-UÇK-së. Materiali i sekuestruar përfshinte, (i)
17 dokumente në lidhje me procedime penale të mëparshme në Kosovë
18 dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë; dhe
19 (ii) dokumente në lidhje me hetime konfidenciale, të cilat
20 kishin qenë gjithashtu pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë
21 Herës së Parë dhe përfshinin identitetin ose të dhënat
22 personale të më së paku tre dëshmitarëve.

23 Pas Konferencës së Dytë për Shtyp, midis 17 dhe 21
24 shtatorit 2020, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Tomë Gashi
25 bënë deklaratë të shumta publike në lidhje me dokumentet e

1 nxjerra gjatë Herës së Parë dhe të Dytë. Në kuadër të këtyre
2 deklaratave Hysni Gucati dhe/ose Nasim Haradinaj publikisht:

3 i. pranuan se dokumentet e nxjerra gjatë Herës së Parë
4 dhe gjatë Herës së Dytë kishin përmbajtje të ndjeshme
5 konfidenciale dhe jopublike;

6 ii. pranuan se me ligj nuk duhet të publikohen identiteti
7 dhe të dhënat personale të dëshmitarëve;

8 iii. pretenduan se dokumentet e sekuestruara nga ZPS-ja
9 ishin vetëm një pjesë e dokumenteve të shpërndara gjatë Herës
10 së Parë dhe të Dytë për Shtyp, pasi që përfaqësues të shtypit
11 dhe të tjerë tashmë kishin marrë pjesën tjetër.

12 iv. konfirmuan se urdhrat e DHS-së ndalonin shpërndarjen
13 e mëtejme të përmbajtjes së dokumenteve gjatë Herës së Parë
14 dhe të Dytë;

15 v. konfirmuan se dokumentet e nxjerra gjatë Herës së
16 Dytë u ishin vënë në dispozicion përfaqësuesve të shtypit dhe
17 ishin marrë prej tyre;

18 vi. zbuluan më shumë nga përmbajtja e dokumenteve të
19 nxjerra gjatë Herës së Parë dhe të Dytë duke përfshirë
20 hollësitë e hetimeve konfidenciale;

21 vii. konfirmuan se dokumentet e shpërndara përmbanin
22 identitetin dhe të dhënat personale të dëshmitarëve;

23 viii. akuzuan dëshmitarët e përmendur në informacionin
24 konfidencial se ishin ndër të tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe
25 tradhtarë.

1 ix. Falënderuan dhe lavdëruan persona që i kishin dhënë
2 OVL-UÇK-së dokumente të nxjerra gjatë Herës së Dytë;

3 x. Premtuan se do të publikonin çfarëdo informacioni
4 konfidencial dhe jopublik të mëtejme që do i jepej OVL-UÇK-së
5 në lidhje me DHS-në dhe ZPS-në.

6 xi. Sfiduan përfaqësuesit e shtypit që nuk kishin
7 publikuar informacion konfidencial dhe jopublik;

8 xii. U thanë përfaqësuesve të shtypit të publikonin
9 informacionin konfidencial dhe jopublik; dhe

10 xiii. Deklaruan se nuk e njihnin DHS-në/ZPS-në dhe se
11 veprimet e tyre kishin për qëllim pengimin e DHS-së dhe ZPS-
12 në.

13 Nxjerrja e Tretë.

14 Më 22 shtator 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj
15 përkatësisht në cilësinë e Kryetarit dhe Nën-Kryetarit të OVL-
16 UÇK-së mbajtën Konferencë për Shtyp, Konferenca e Tretë për
17 Shtyp, në të cilën Hysni Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte
18 marrë dokumente që besohet se kishin rrjedhur nga DHS/ZPS-ja.
19 Njihet si dokumentet e nxjerra gjatë Herës së Tretë. Hysni
20 Gucati tregoi njërin prej dokumenteve dhe ftoi të pranishmit
21 të afroheshin për ta parë atë.

22 Të nderuar Gjykatës duam që në këtë moment të futemi në
23 seancë private për tre minuta për shkak të informacionit të
24 redaktuar.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit të nderuar. Pra, po e
11 lexoj aty ku e lashë.

12 Nasim Haradinaj deklaroi se dokumentet kishin stemën e
13 ZPS-së dhe se mesa kuptonte ai kishin të bënin me projekt
14 aktakuzën. Duke i referuar përmbajtjes së dokumenteve, ai
15 përmendi me emër pesë persona të akuzuar, të mundshëm, - është
16 redaktuar - , [REDAKTUAR] dhe identifikoi persona të tjerë në
17 vendndodhje të tjera. Nasim Haradinaj i ftoi të pranishmit të
18 shihnin, incizonin dhe publikonin përmbajtjen. Ai gjithashtu
19 deklaroi se OVL-UÇK-ja do të merrte dhe shpërndante
20 informacion të mëtejshëm konfidencial dhe jopublik në lidhje
21 me DHS/ZPS-në.

22 Më 22 shtator 2020, ZPS-ja nxori një urdhër për dorëzimin
23 e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të Herës së Tretë,
24 dhe se çdo person që posedonte këto dokumente apo përmbajtjen
25 e tyre të mos i kopjonin, incizonin apo shpërndanin ato.

1 Njihet si 'Urdhri i Tretë'. Po atë ditë ZPS-ja dorëzoi Urdhrin
2 e Tretë dhe sekuestroi dokumentet në ambiente të OVL-UÇK-së.
3 Materialet e sekuestruara përfshinin informacioni konfidencial
4 dhe jopublik, në lidhje me hetimet konfidenciale, duke
5 përfshirë identitetet, të dhënat personale dhe dëshmi të
6 dëshmitarëve.

7 Pas Konferencës së Tretë për Shtyp, midis 22 dhe 25
8 shtator, 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj bënë deklaratë
9 të shumta publike në lidhje me Nxjerrjen e Tretë. Në kuadër të
10 këtyre deklaratave, Hysni Gucati dhe/ose Nasim Haradinaj
11 publikisht:

- 12 i. konfirmuan që dokumentet e nxjerra gjatë Herës së
13 Tretë t'ju shpërndahen shtypit;
- 14 ii. është redaktuar diçka;
- 15 iii. inkurajuan personat që posedonin informacion
16 konfidencial dhe jopublik në lidhje me DHS/ZPS-në të vazhdonin
17 t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së;
- 18 iv. i premtuan publikut se do të jepnin çdo informacion
19 konfidencial dhe jopublik të mëtejme që do t'i jepej OVL-UÇK-
20 së në lidhje me DHS/ZPS-në;
- 21 v. deklaruan se nuk e njihnin DHS/ZPS-në dhe se
22 veprimet e tyre kishin për qëllim pengimin e DHS/ZPS-së.

23 Pas Konferencës së Tretë për Shtyp dhe gjatë ditëve në
24 vijim, disa përfaqësues të shtypit dhe të publikut shpërndanë
25 mëtej në shtyp dhe në internet informata me emra dhe të dhëna

1 personale dëshmitarësh, që përfshiheshin në dokumentet e
2 nxjerra gjatë Herës së Tretë.

3 Si rezultat i Nxjerrjes së Parë, së Dytë dhe të Tretë,
4 dhe ngjarjeve të lidhura me to të përshkruara më lart, u
5 frikësuan dëshmitarë dhe/ose anëtarë të familjeve të tyre. Dhe
6 u vu në rrezik siguria, privatësia, reputacioni dhe jetesa e
7 tyre. Për më tepër, ZPS-ja u detyrua të merrte masa për të
8 trajtuar pasojat reale dhe të mundshme, ndër të tjera, për
9 dëshmitarët dhe procedurat e DHS-së.

10 Dokumentet konfidenciale dhe jopublike të shpërndara
11 gjatë Herës së Parë, të Dytë dhe të Tretë, në vazhdim do të
12 quhen "Informacion Konfidencial".

13 Krimet/Veprat Penale.

14 Në bazë të fakteve të paraqitura në paragrafët 4 deri në
15 22, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj mbajnë përgjegjësi penale
16 individuale për çdonjërën nga veprat penale të renditura më
17 poshtë. Sikurse përshkruhet në paragrafët 45-46, ata kishin
18 dijeni dhe synimin e nevojshëm për çdonjërën nga veprat
19 penale.

20 Midis së paku 7 dhe 25 shtator 2020, Hysni Gucati, Nasim
21 Haradinaj dhe Ndihmësit me anë të kërcënimit të rëndë dhe/ose
22 duke vepruar bashkërisht penguan ose tentuan të pengonin
23 Procedurat e DHS-së. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj
24 organizuan dhe bashkërenduan grupin që kreu veprime të tilla.

25 Në veçanti, sikurse përshkruhet në paragrafët 6 deri në

1 9, 11 deri në 14, 16 deri në 18 dhe 20 deri në 21, në shumë
2 raste midis së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, Hysni Gucati,
3 Nasim Haradinaj dhe Ndhmësit e tyre (i) shpërndanë
4 informacioni konfidencial; (ii) akuzuan dëshmitarët e
5 përmendur në informacionin konfidencial se ishin ndër të
6 tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe tradhtarë; dhe (iii) deklaruan
7 se me shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe veprimet e
8 lidhura me të, ata kishin për qëllim pengimin e Procedurave të
9 DHS-së. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj gjithashtu
10 inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan publikisht:

11 (i) disa përfaqësues të publikut që posedonin dhe/ose
12 kishin qasje në informacion konfidencial në lidhje me
13 procedurat e DHS-së, të vazhdonin t'i jepnin informacion të
14 tillë OVL-UÇK-së; dhe

15 (ii) disa përfaqësues të shtypit dhe publikut të merrnin
16 ose incizonin dhe shpërndanin e publikonin më tej
17 informacionin konfidencial.

18 Mbas nxjerrjes të paktën të Parë dhe të Tretë të
19 dokumenteve, një pjesë e informacionit konfidencial u shpërnda
20 më tej në shtyp dhe në internet, sikurse përshkruar në
21 paragrafët 12 dhe 21.

22 Së fundi, sikurse përshkruar në paragrafin 22, veprimet e
23 Hysni Gucatit, Nasim Haradinaj dhe të Ndhmësve të tyre
24 penguan ose tentuan të pengonin Procedurat e DHS-së: (i)
25 frikësuan dëshmitarët; (ii) rrezikuan aftësinë e ZPS-së për

1 hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të krimeve përfshirë
2 nëpërmjet marrjes dhe sigurimit të provave të rëndësishme; dhe
3 (iii) ZPS-ja përqendroi kapacitetin dhe kohën e vet në
4 trajtimin e pasojave reale dhe të mundshme, ndër të tjera, për
5 dëshmitarët dhe Procedurat e DHS-së.

6 Frikësimi gjatë procedurës penale.

7 Midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, Hysni Gucati
8 dhe Nasim Haradinaj dhe Ndihmësit përdorën kërcënime të rënda
9 për të nxitur ose për të tentuar të nxisnin dëshmitarët që të
10 mos jepnin deklaratë ose të jepnin deklaratë të rreme ose
11 ndryshe të mos jepnin informacion të vërtetë ZPS-së dhe DHS-
12 së.

13 Në veçanti sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14,
14 16-18 dhe 20-21, në raste të shumta, Hysni Gucati, Nasim
15 Haradinaj dhe Ndihmësit të tyre:

16 i. u shpërndanë përfaqësuesve të shtypit dhe publikut
17 emra, të dhëna personale, dhe dëshmi të qindra dëshmitarëve;

18 ii. pranuan që informacioni konfidencial përfshinte
19 emrat dhe të dhënat e dëshmitarëve të mbrojtur;

20 iii. gjatë paraqitjeve publike zbuluan identitetin e
21 dëshmitarëve, vendin e banimit, dhe të dhënat personale dhe
22 hollësi të tjera në lidhje me ta, përfshirë datat dhe vendet
23 ku ishin intervistuar;

24 vi. akuzuan dëshmitarët e identifikuar në Informacionin
25 Konfidencial se ishin ndër të tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe

1 tradhtarë;

2 v. inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan disa përfaqësues
3 të publikut që posedonin Informacion Konfidencial në lidhje me
4 Procedurat e DHS-së ose kishin qasje në një informacion të
5 tillë të vazhdonin një informacioni të tillë OVL-UÇK-së;

6 vi. inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan disa përfaqësues
7 të shtypit dhe publikut të merrnin dhe incizonin dhe më pak
8 shpërndarjen e publikonin më tej, Informacion Konfidencial;

9 vii. deklaruan dhe me veprimet e tyre demonstuan
10 indiferencën e tyre për sigurinë e dëshmitarëve të
11 identifikuar në Informacionin Konfidencial; dhe

12 viii. deklaruan se qëllimi i tyre i shpërndarjes së
13 Informacionit Konfidencial dhe i veprimeve në lidhje me të
14 ishte pengimi i Procedurave të DHS-së.

15 Hakmarrja.

16 Midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit, 2020, Hysni Gucati,
17 Nasim Haradinaj dhe Ndhmësit e tyre ndërmorën ose tentuan të
18 ndërmerrnin veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve me synimin
19 e hakmarrjes për dhënien ZPS-së të informacionit të besueshëm
20 me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.

21 Në veçanti, veprimet dhe mosveprimet e përshkruara në
22 paragrafin 30 më lart, shkelën të drejtat themelore të
23 dëshmitarëve të garantuara në Kushtetutën e Republikës së
24 Kosovës dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. U
25 frikësuan dëshmitarë dhe/ose anëtarë të familjeve të tyre dhe

1 u vu në rrezik siguria, privatësia, reputacioni dhe jetesa e
2 tyre.

3 Shkelja e fshehtësisë të Procedurës.

4 Sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18 dhe
5 20-21, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, Hysni Gucati,
6 Nasim Haradinaj dhe Ndhmësit e tyre zbuluan Informacion
7 Konfidencial pa autorizim. Ata gjithashtu inkurajuan,
8 udhëzuan dhe këshilluan (i) disa përfaqësues të publikut që
9 posedonin ose kishin qasje në Informacion Konfidencial në
10 lidhje me Procedurat e DHS-së të vazhdonin t'i jepnin
11 informacion të tillë OVL-UÇK-së; (ii) disa përfaqësues të
12 shtypit dhe publikut që të merrnin ose incizonin dhe të
13 shpërndanin e publikonin më tej Informacion Konfidencial
14 Informacioni Konfidencial nuk duhej të zbulohet sipas ligjit
15 dhe/ose të ishte i klasifikuar nga autoritetet kompetente,
16 ndër të tjera DHS-ja, TFHS-ja, ZPS-ja dhe organizatat dhe
17 shtetet bashkëpunuese në bazë të një marrëveshjeje me
18 TFHS/ZPS-në. Informacioni ishte i klasifikuar në përputhje me
19 Nenet 4(2), 23, 35(2)(d) deri në (f), 39, 54(8), 61(3) deri në
20 (4) dhe 62 të ligjit.

21 Gjithashtu sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14,
22 16-18 dhe 20-21, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020,
23 Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, dhe Ndhmësit e tyre zbuluan
24 ose tentuan të zbulonin pa autorizim identitetin dhe të dhënat
25 personale të dëshmitarëve të mbrojtur në kontekstin e

1 Procedurave të DHS-së dhe procedimeve të tjera penale të
2 mëparshme në Kosovë. Ata gjithashtu inkurajuan, udhëzuan dhe
3 këshilluan përfaqësues të shtypit dhe publikut të mos buronin
4 pa autorizim informacion të tillë.

5 Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Ndhmësit e tyre
6 deklaruan publikisht se Informacioni Konfidencial përfshinte
7 identitetin, të dhënat personale, dëshmi të dëshmitarëve dhe
8 ishte në lidhje me hetimet konfidenciale të TFHS/ZPS-së. Hysni
9 Gucati, Nasim Haradinaj dhe Ndhmësit e tyre pranuan që me
10 ligj identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve nuk
11 duhet të shpërndareshin publikisht. Përkundrazi në përputhje
12 me ligjin, Informacioni Konfidencial duhej të ishte zbuluar
13 vetëm në kontekstin e Procedimeve Penale, në vartësi të
14 garancive dhe masave mbrojtëse të nevojshme.

15 Sikurse përshkruhet në paragrafët 22 dhe 32 më lart,
16 zbulimi i paautorizuar i identitetit dhe të dhënave personale
17 të dëshmitarëve të mbrojtur rezultoi në pasoja të rrezikshme
18 për dëshmitarët dhe pengoi rëndë hetimet e ZPS-së.

19 Format e përgjegjësisë penale.

20 Bazuar në faktet e paraqitura në paragrafët 4-22, Hysni
21 Gucati dhe Nasim Haradinaj mbajnë përgjegjësi penale
22 individuale për veprat penale të përshkruara më lart përmes
23 formave të përgjegjësisë penale të renditura në vijim.

24 Sikurse përshkruhet në paragrafët 45-46, ata kishin
25 dijeni dhe synimin e nevojshëm për secilën formë të

1 përgjegjësisë penale dhe secilën veprë penale.

2 Kryerja dhe tentimi.

3 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj i kryen veprat penale
4 përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët
5 1-9, 11, 13-14, 16-18, 20.

6 Gjithashtu ose në alternativë, nëpërmjet veprimeve dhe
7 mosveprimeve të përshkruara në paragrafët 6-9, 11, 13-14, 16-
8 18, 20, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj tentuan në kuptim të
9 Nenit 28 të KPK-së, të kryenin vepra penale të pengimit të
10 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimi
11 gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së
12 fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe
13 të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

14 Bashkëkryerja dhe marrëveshja për të kryer veprë penale.

15 Sikurse del qartë nga qëllimi i tyre i deklaruar i
16 pengimit të DHS/ZPS-së dhe nga veprimet e bashkërenduara për
17 realizimin e qëllimi të përbashkët të përshkruar në paragrafët
18 6-9, 11-14, 16-18, 20-21 Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe
19 Ndihmësit e tyre i kryen veprat penale bashkërisht dhe/ose
20 ranë në marrëveshje për kryerjen e veprave penale. Hysni
21 Gucati dhe Nasim Haradinaj kontribuan konsiderueshëm dhe
22 ndërmoren veprime të rëndësishme për kryerjen e veprave penale
23 në realizimin e qëllimit ose marrëveshjes së përbashkët, ndër
24 të tjera, nëpërmjet njërës apo apo shumë prej mënyrave të
25 mëposhtme sikur përshkruhet më hollësisht në paragrafët

1 Çështjes Gjyqësore Nr. 6-9, 11, 13-14, 16-18 dhe 20:

2 i. këqyrjes së Informacionit Konfidencial;

3 ii. vendimmarrjes ose pjesëmarrjes në vendime në se dhe
4 si do të shpërndahej Informacioni Konfidencial;

5 iii. organizimi dhe pjesëmarrjes në ngjarje duke
6 përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike, në të
7 cilat Informacioni Konfidencial u shpërnda dhe u diskutua
8 publikisht;

9 iv. shpërndarjes së Informacionit Konfidencial;

10 v. zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të
11 dëshmitarëve ndër të cilët dëshmitarë të mbrojtur;

12 vi. akuza dhe kundër dëshmitarëve dhe komenteve
13 nënçmuese në lidhje me dëshmitarët;

14 vii. inkurajimi dhe këshillimi i personave me qasjen e
15 Informacionit Konfidencial në lidhje me Procedurat e DHS-së që
16 të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së dhe të
17 premtinin që do të vazhdonin të shpërndanin informacion të
18 tillë konfidencial dhe/ose inkurajimit, udhëzimit dhe
19 këshillimit të përfaqësuesve të mediave dhe publikut, që të
20 merrnin ose incizonin Informacionin Konfidencial; dhe/ose

21 viii. inkurajimit, udhëzimit dhe këshillimit të
22 përfaqësuesve të mediave dhe publikut që të merrnin ose
23 incizonin Informacion Konfidencial dhe ta shpërndanin atë më
24 tej.

25 Nxitja.

1 Njëpërmjet një ose më shumë veprimeve të përshkruara në
2 paragrafin 40(ii) deri në (vii) [sipas përkthimit], Hysni
3 Gucati dhe Nasim Haradinaj nxitën njëri tjetrin, Ndhmësit,
4 dhe të tjerët, konkretisht personat, ndër të cilët (i)
5 personat, të cilët përmes mjeteve ose praninë e tyre fizike
6 morën pjesë, përcollën ose ndryshe u informuan për tri
7 konferencat të cilat u përshkruan në paragrafët 8-9, 11, 13-
8 14, 16-18 dhe 20 më lart; (ii) disa përfaqësues të shtypit;
9 dhe (iii) persona që posedonin ose kishin qasje në
10 informacionin konfidencial jopublik në lidhje me Procedurat e
11 DHS-së, bashkërisht "Persona të Tjerë" për të kryer veprat
12 penale të përmendura më lart.

13 Gjithashtu ose në alternativë, njëpërmjet një apo më shumë
14 veprimeve të përshkruara në paragrafët 40(ii) deri në (viii),
15 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj: (i) nxitën njëri tjetrin,
16 Ndhmësit dhe Persona të Tjerë, që të kryenin veprimet penale
17 të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave
18 zyrtare, frikësimin gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe
19 shkeljes së fshehtësisë së procedurës; dhe (ii) u tentua
20 kryerja e këtyre veprimeve penale.

21 Gjithashtu ose në alternativë, njëpërmjet një apo më shumë
22 veprimeve të përshkruara në paragrafët nga 40(ii) deri në
23 (viii), Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj: (i) nxitën njëri-
24 tjetrin, Ndhmësit dhe Persona të Tjerë, që të kryenin veprat
25 penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave

1 zyrtare, frikësimin gjatë procedurës penale dhe shkeljes së
2 fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe
3 të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur; dhe (ii)
4 vepra të tilla penale nuk u kryen as u tentuan të kryheshin.

5 Ndihma.

6 Së fundi, nëpërmjet një ose më shumë veprimeve të
7 përshkruara në paragrafin 40, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj
8 ndihmuan njëri-tjetrin, Ndihmësit dhe Persona të Tjerë për
9 kryerjen e veprave penale të përshkruara më lart.

10 Synimi.

11 Siç del qartë nga sjellja dhe deklaratat e qëllimshme të
12 tyre të përshkruar në paragrafët 5 deri në 9, 11 deri në 14,
13 16 deri në 18 dhe 20 deri në 21, në të cilat shpërndarja e
14 Informacionit Konfidencial, akuzat kundër dëshmitarëve,
15 indiferenca ndaj sigurisë së dëshmitarëve, deklaratat ku
16 pranohet natyra konfidenciale e Informacionit Konfidencial, si
17 dhe qëllimi i deklaruar i pengimit të punës së DHS/ZPS-së,
18 Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe sipas rastit Ndihmësit dhe
19 Persona të Tjerë, synuan kryerjen e veprave penale të
20 përshkruara më lart, dhe nxitjen e tyre, dhe për ndihmën për
21 kryerjen e këtyre veprave.

22 Në alternative, sikurse del qartë nga sjellja dhe
23 deklaratat e qëllimshme të tyre, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj
24 dhe sipas rastit Ndihmësit dhe Persona të Tjerë: (i) ishin të
25 vetëdijsëm sesi pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tyre

1 mund të kryheshin vepra penal të përshkruara më lart dhe se
2 veprimet ose mosveprimet e tyre mund të nxisnin kryerjen e
3 veprave penale apo të ndihmonin në kryerjen e tyre; dhe (ii) u
4 pajtuan me kryerjen e tyre.

5 Paraqitja e veprave penale.

6 Njëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më
7 lart, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj:

8 i. kryen vetëm ose bashkë me të tjerët veprat penale të
9 pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare,
10 frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes, edhe shkeljes
11 së fshehtësisë së procedurës;

12 ii. tentuan të kryenin veprat penale të pengimit të
13 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit
14 gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së
15 fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe
16 të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur;

17 iii. u morën vesh që të kryenin veprat penale të
18 pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare,
19 frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së
20 fshehtësisë së procedurës dhe morën veprime të rëndësishme për
21 kryerje e këtyre veprave penale;

22 iv. nxitën dhe ndihmuan në kryerjen e veprave penale të
23 pengimit personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare,
24 frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes, dhe shkeljes
25 së fshehtësisë së procedurës;

1 v. nxitën kryerjen e veprave penale të pengimit të
2 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit
3 gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së
4 fshehtësisë së procedurës dhe u tentua kryerja e këtyre
5 veprave penale;

6 vi. dhe/ose nxitën kryerjen e veprave penale të pengimit
7 të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare,
8 frikësimit gjatë procedurës penale, dhe shkeljes së
9 fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe
10 të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur dhe vepra të
11 tilla penale nuk u kryen e as u tentuan të kryheshin.

12 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj mbajnë përgjegjësi
13 penale individuale për:

14 Pika 1: Pengim të personave zyrtarë për kryerjen e
15 detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë midis më së
16 paku datës 7 dhe 25 shtatorit 2020, vepër penale kundër rendit
17 publik e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1) deri
18 në (3), 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) dhe nenet 15(2) dhe 16(3) të
19 Ligjit.

20 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
21 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e
22 përbashkët të një grupi midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit
23 2020, vepër penale kundër rendit publik e ndëshkueshme në bazë
24 të neneve 17, 28, 32(1) deri në (3), 33, 35 dhe 401(2) deri në
25 (3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

1 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale, midis më së
2 paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, vepër penale kundër
3 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e
4 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1) deri në (3),
5 33, 35 dhe 387 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

6 Pika 4: Hakmarrje, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit
7 2020, vepër penale kundër administrimit të drejtësisë dhe
8 administratës publike, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17,
9 28, 31, 32(1) deri në (2), 33, 35 dhe 388(1) të KPK-së dhe
10 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

11 Pika 5: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes
12 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë, të
13 nxjerrë në procedurat zyrtare midis më së paku 7 dhe 27
14 shtatorit 2020 [sipas përkthimit], vepër penale kundër
15 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e
16 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 31, 32(1) deri në (2), 33,
17 35 dhe 392(1) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;
18 dhe

19 Pika 6: Shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes
20 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
21 personale të dëshmitarëve të mbrojtur midis më së paku 7 dhe
22 25 shtatorit 2020, vepër penale kundër administrimit të
23 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë
24 të neneve 17, 28, 31, 32(1) deri në (3), 33, 35 dhe 392(2)
25 deri në (3) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

1 Të gjitha pjesët e kësaj aktakuze duhet të lexohen në
2 lidhje me njëra-tjetrën.

3 Të nderuar Gjykatës ky është fundi i leximit të
4 aktakuzës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
6 z. Halling.

7 Unë tani kam disa pyetje për të akuzuarin. Së pari z.
8 Gucati, a mund të ngrihesh në këmbë?

9 Po ju pyes z. Gucati në përputhje me Rregullën 103(3)
10 [sipas përkthimit] n.q.s. e kuptoni aktakuzën e ngritur kundër
11 jush.

12 I AKUZUARI GUCATI: Po e kuptoj.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,
14 gjatë Paraqitjes Fillestare në Dhjetor, me 18 dhjetor, 2020,
15 juve u vetë-deklaruat si jo-fajtor për asnjë nga pikat e
16 aktakuzën në Aktakuzën e Konfirmuar. Tani keni mundësinë që ta
17 konfirmoni këtë vetë-deklarim. A e konfirmoni vetë-deklarimin
18 fillestar të dhënë?

19 I AKUZUARI GUCATI: Para se të deklarohena, kisha pasë
20 mundësi të më jepni nja dy minuta kohë për një lexim të
21 shkurtër për biografinë time, nëse ka mundësi dy minuta.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,
23 tani dua të bëj këtë pyetje dhe thjesht më thoni po ose jo,
24 dhe pastaj gjërat e tjera do t'i trajtojmë më vonë. Kështu që
25 ju lutem më thoni n.q.s. e konfirmoni vetë-deklarimin jo-

1 fajtor për aktakuzat e ngritura kundër jush. Po ose jo?

2 I AKUZUARI GUCATI: I pafajshëm në të gjitha aktakuzat që
3 më keni ngrit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me këtë
5 deklaratë do të thuash që konfirmon vetë-deklarimin si jo-
6 fajtor. Po apo jo?

7 I AKUZUARI GUCATI: I nderum, plotësisht i pafajshëm në të
8 gjitha aktakuzat që mi vë Prokurori. I pafajshëm jam
9 plotësisht.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
11 z. Gucati, tani mund të uleni.

12 I AKUZUARI GUCATI: Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Haradinaj,
14 a mund të ngriheni në këmbë ju lutem?

15 Do t'ju bëj të njëjtën pyetje që sapo i bëra z. Gucati.

16 Në përputhje me Rregullin 124(3), dua t'ju pyes n.q.s. e
17 kuptoni aktakuzën e ngritur kundër jush; po apo jo?

18 I AKUZUARI HARADINAJ: I pafajshëm dhe çdoherë kundër
19 padrejtësisë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja e parë
21 është n.q.s. e kuptoni aktakuzën e ngritur kundër jush. Po apo
22 jo?

23 I AKUZUARI HARADINAJ: Këtë aktakuzën s'muj as ta kuptoj,
24 por atë që lexut e ndëgjova.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptuat se

1 çfarë u tha?

2 I AKUZUARI HARADINAJ: Po, çka u tha e kuptova, po s'e
3 kuptova si aktakuzë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ke nevojë
5 që të ndalosh dhe ti bësh pyetje avokatit tënd?

6 I AKUZUARI HARADINAJ: Jo, jo, s'kam nevojë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra më tej në
8 refuzimin për të deklaruar pafajësinë tuaj, më 8 janar 2021,
9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në emrin tuaj shpalli
10 pafajësinë tuaj në lidhje me aktakuzën e konfirmuar. A e
11 konfirmoni këtë gjë? A është akoma pozicioni juaj ky?

12 I AKUZUARI HARADINAJ: I pafajshëm.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 mund të zini vend z. Haradinaj.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Gucati dhe
16 z. Haradinaj, tani më lejoni t'ju informoj për disa të drejta
17 të rëndësishme, të cilat ju jepen nga kjo Gjykatë në vartësi
18 të bazës ligjore të saj.

19 Ju keni të drejtën që të heshtni, pak heshtje duke u
20 interpretuar si pjesë e fajësisë tuaj.

21 Ju keni të drejtë që të mos detyroheni që të jepni dëshmi
22 apo të pranoni fajësinë.

23 Keni të drejtë që të mos vetë-inkriminoheni apo të mos
24 inkriminoni dhe anëtarë të tjerë të familjes apo të afërm të
25 tjerë.

1 Keni të drejtë që të përfaqësoheni nga avokatët tuaj
2 mbrojtës. Dhe e di që ju përfaqësoheni nga Avokatët Mbrojtës.

3 Keni të drejtë që të keni mjetet dhe kohën e mjaftueshme
4 për të përgatitur për mbrojtjen tuaj dhe për të komunikuar me
5 avokatët tuaj.

6 Keni të drejtë që të gjykojeni brenda kohës së arsyeshme.

7 Keni të drejtë që të pyesni dëshmitarët kundër jush dhe
8 po ashtu të kërkoni dhe paraqitjen e dëshmitarëve në anën
9 tuaj.

10 Keni të drejtë po ashtu që të bëni deklaratë jo nën-
11 betim, që ka të bëjë me çështjen dhe gjithashtu të shfaqeni si
12 dëshmitar nën dëshmi.

13 Sapo ju thashë se cilat janë të drejtat tuaja z. Gucati
14 dhe z. Haradinaj. Pra, përpara se të kaloj më tej, mua më
15 kërkohet mbi bazën e Rregullores që t'ju informoj mbi
16 detyrimet dhe masat, të cilat duhet që të ndiqen në pajtim me
17 Nenin 61(2) të Rregullores.

18 Si Drejtues i këtij Paneli, unë jam përgjegjës për rendin
19 në sallën gjyqit dhe gjithashtu për sjelljen e pjesëmarrësve.
20 Megjithëse nuk mendoj që është e nevojshme, është detyra ime
21 z. Gucati dhe z. Haradinaj t'ju them që n.q.s. juve nuk
22 silleni mirë pas një paralajmërimi të dhënë që sjellja e tillë
23 mund të rezultojë, mund të çojë në heqjen tuaj, largimin tuaj
24 nga salla.

25 N.q.s. kjo ndodh, atëherë interesat tuaja do të

1 përfaqësohen nga Avokatët Mbrojtës. Ndërkohë që Trupi Gjykses
2 do marrë masat e nevojshme që ju të konsultoheni me Avokatët
3 duke mos qenë këtu. Megjithatë siç e thashë edhe më përpara,
4 nuk mendoj që kjo masë do jetë e nevojshme.

5 Ndërkohë që për të gjithë të tjerët që janë në sallë dhe
6 në galerinë e publikut dua t'ju kujtoj që unë si Drejtuesi i
7 Panelit mund të marr masat e nevojshme për heqjen e një
8 personi për të siguruar të drejtën e të akuzuarit për një
9 proces të rregullt ligjor dhe për të ruajtur dinjitetin e
10 procedurave të Gjykatës. Po ashtu mund të jap urdhër për arsye
11 sigurie për persona të cilët janë në sallë ose në galerinë e
12 publikut n.q.s. do të dalë e nevojshme për administrimin e
13 drejtësisë.

14 Përpara sesa ti jap fjalën Zyrës së Prokurorit të
15 Specializuar, për të bërë deklaratën hapëse, që besoj që do ta
16 bëjmë pasi të bëjmë pushimin e paradites, dua të nxjerr në pah
17 disa çështje shqetësuese për Panelin.

18 Materialin që pretendohet që të jetë nxjerrë dhe botuar
19 në mënyrë të paligjshme, pretendohet që të përmbajë emrat e
20 individëve të ndryshëm që lidhen me hetimet nga SITF-ja/ZPS-
21 ja. Deri në kohën që Paneli të përcaktojë n.q.s. ky material
22 është konfidencial në natyrë, palët nuk duhet t'i referohen
23 këtij dokumenti në seancë publike.

24 Si rezultat neve presim që palët të kenë dhe të ushtrojnë
25 kujdesin e nevojshëm sa i takon emrave dhe hollësive, të cilët

1 kanë të bëjnë me individë dhe n.q.s. është e nevojshme, palët
2 mund të kërkojnë seanca private, n.q.s. emri ose funksioni i
3 individëve të tillë mendohet se është i rëndësishëm për një
4 çështje që duhet të ngrenë ose një parashtrim që duan të
5 bëjnë. Ju lutem konsiderojeni këtë si paralajmërim zyrtar.

6 Dua gjithashtu të bëj një deklaratë të hapur, që ka të
7 bëjë me redaktimet dhe sesionet e mbyllura dhe private.

8 Ky Panel udhëzohet nga fakti se ky gjykim synohet të jetë
9 publik në nivelin më të madh të mundshëm. Ky besim pra
10 theksohet nga Rregullat e Procedurës dhe të Provave. Pra emrat
11 e redaktuar dhe gjithashtu informacioni i identifikuar
12 personal i redaktuar i dëshmitarëve është i mundur.

13 Dhe pavarësisht kësaj, dua të them që ne do të udhëzohemi
14 nga parimi i përgjithshëm i të qenit publik, dhe nuk do të
15 pranojmë në prova dokumente të cilët janë konsideruar nga
16 Paneli si redaktime të tepërta dhe të cilat mund ta lënë
17 publikun e përgjithshëm në një gjendje panjohje dhe padijeni
18 sa i takon informacionit që është i rëndësishëm.

19 Po ashtu sesionet private dhe të mbyllura do të përdoren
20 me pakicë dhe ndërkohë Avokatët udhëzohen që të planifikojnë
21 pyetjen e tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kujdes
22 dhe që të shmangin përsëritjen e gjërave.

23 Së fundi, dua t'i kujtoj palëve që të respektojnë, të
24 respektojnë udhëzimet të cilat jepen në Urdhrin e Sjelljes së
25 Procedurave dhe përveç kësaj palët janë të informuar gjatë

1 prezantimit dhe përfaqësimit të paraqitjes së provave dhe
2 pritjet që të sillen në përputhje me rregullën për sa i takon
3 Sjelljes së Procedurave. Ndërkohë provat, të cilat do të
4 tregohen këtu në sallën e gjyqit nuk do të transmetohen
5 publikisht n.q.s. nuk vendoset ndryshe nga Paneli. Ndërkohë do
6 ju kërkoja palëve që ata t'i referoheshin numrit përkatës të
7 provës materiale si dhe të tregojnë se cilat janë faqet
8 përkatëse korresponduese si në versionin në shqip edhe në
9 versionin anglisht në vartësi të materialit specifik.

10 Dhe pas deklaratës hapëse, ne - mendoj që është një pikë
11 e rëndësishme që të ndalojmë të bëjmë pushimin e paradites.
12 gjithsesi do ju kërkoja që të ishit të pranishëm në sallë në
13 orën 11.25, në mënyrë që të ishim të gatshëm të fillonim
14 pastaj pushimit të kafes, me deklaratën e Prokurorisë.

15 Faleminderit. Kemi 30 minuta pushim tani dhe do kthehemi
16 së bashku për 30 minuta.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar, juve thatë që do të
18 bënit një vendim lidhur me atë se çfarë tha z. Rees më
19 përpara. Pra ju thatë që do të jepni një urdhër me gojë për
20 çështjen e ngritur nga z. Rees në fillim të seancës sot.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e dhashë
22 urdhrin me gojë. Pra urdhri që dhashë unë ishte që Rregulli
23 117(2) - pra kërkesa e bërë mbështetur në këtë rregull, së
24 bashku prej jush dhe z. Rees rrëzohet dhe ndërkohë ne po
25 shkruajmë vendimin e shkruar dhe do tua japim atë të

1 justifikuar dhe të arsyetuar më pas.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Pyetja ime është kjo - mund të kemi
3 një vlerësim të përafërt të kohës, sepse provat do të fillojnë
4 që të jepen nga Prokuroria më datën 18.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i keni
6 ndoshta edhe nesër, do ta keni të arsyetuar këtë vendim të
7 dhënë sot.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani bëjmë
9 pushim.

10 --- Pauza fillon në orën 10.53 paradite

11 --- Seanca rifillon në orën 11.26 paradite

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
13 lutem. Përpara se t'ja jap fjalën Zyrës së Prokurorit të
14 Specializuar, dëshiroj ta bëj të qartë se në pajtim me
15 Rregullën 126, deklarata hyrëse e ZPS-së nuk përbën provë.
16 Megjithatë, kjo i jep mundësi ZPS-së të paraqesë një pamje të
17 përgjithshme dhe të bëjë të ditura provat që do të përpiqet të
18 paraqesë në gjykim.

19 Z. Prokuror, keni fjalën.

20 Z. SMITH: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, zonja
21 Administratore, Avokatë, mirëdita. Si Prokuror i Specializuar,
22 kam kënaqësinë dhe privilegjin t'ju drejtohem sot që fillojmë
23 gjyqin e dytë të kësaj Gjykate. Gjyqi që fillojmë sot dallon
24 nga gjyqi që filluam muaji që shkoi, apo nga gjyqet e tjera që
25 do të vijjnë, në kuptimin që akuzat e ngritura nuk kanë të

1 bëjnë drejtpërdrejtë me ngjarjet e luftës në Kosovë të përpara
2 20 vjetëve, por kanë të bëjnë me ngjarje që kanë ndodhur jo më
3 larg se vjet. Ato kanë të bëjnë me orvatje për t'i frikësuar
4 që mos t'i tregojnë kësaj Gjykate se çfarë u ka ndodhur para
5 20 vjetësh dhe me orvatje për ta penguar me çdo kosto punën e
6 këtij institucioni. Ato kanë të bëjnë me atmosferën e
7 ndërhyrjes dhe të frikësimit që ekziston në çështjen dhe
8 hetimet e lidhura ma ish anëtarët e UÇK-së, të cilat të
9 akuzuarit kanë kërkuar t'i nxisin në favor të tyre.

10 Të nderuar Gjykatës, kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me
11 kushtet e nevojshme për administrimin e drejtë të drejtësisë
12 dhe me orvatjet e të akuzuarve për t'i bllokuar rrugën
13 drejtësisë për shumë vetë. Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me
14 atë që nevojitet për ta vënë në jetë shtetin ligjor.

15 Në çdo shoqëri, administrimi i drejtësisë kërkon ngritjen
16 dhe nxitjen e institucioneve që mund t'i mbrojnë ata që
17 kërkojnë drejtësi. Kjo Gjykatë është krijuar me ligj të
18 miratuar në Kosovë dhe ka aftësinë të vendos në vend
19 drejtësinë për shumë e shumë viktima në Kosovë. Arsyeja pse e
20 ka këtë mundësi është se ajo përbën një vend të mbrojtur për
21 dëshmitarët ku të flasin hapur. Të flasin hapur për krimet që
22 kanë parë, krimet që kanë pësuar ata vetë dhe krimet që kanë
23 parë të pësojnë familjarët e tyre. Më e rëndësishme, kjo
24 Gjykatë përbën një vend ku këtë ata mund ta bëjnë pa pasur
25 frikë nga hakmarrja.

1 Kjo Gjykatë mund ta bëjë punën e saj vetëm nëse
2 dëshmitarët ndihen të pa rrezikuar për t'i treguar historitë e
3 tyre.

4 Aftësia e jonë si institucion për t'i mbrojtur
5 dëshmitarët e familjet e tyre nga frikësimi, nga hakmarrja dhe
6 më e keqja, përbën themelin mbi të cilin duhet ngritur një
7 Gjykatë e efektshme e kësaj natyre. E thënë shumë thjeshtë,
8 Dhomat e Specializuara të Kosovës nuk mund ta kryejnë
9 efektivisht detyrën nëse lejohen të ndodhin veprime si ato të
10 të akuzuarve.

11 Nëse besojmë se kjo Gjykatë dhe gjykatat e tjera si kjo,
12 janë një gjë e mirë, atëherë duhet t'u japim mundësi
13 plotësisht, t'i mbrojnë njerëzit të cilëve iu shërbejmë. Kjo
14 Gjykatë është ngritur në të vërtetë që të bëjë pikërisht këtë
15 gjë, prandaj edhe ata që e kanë hartuar ligjin tonë dhe që e
16 kanë krijuar këtë Gjykatë, kanë përfshirë posaçërisht në
17 kompetencën e saj disa prej pikërisht të njëjtave krime për të
18 cilat akuzohen të akuzuarit: frikësim gjatë procedimit penal,
19 hakmarrje, pengim të personave zyrtarë me anë të kërcënimit të
20 rëndë, dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës me anë të
21 nxjerrjes së identitetit të personave të mbrojtur. Dispozitat
22 që të akuzuarit akuzohen se i kanë shkelur, janë në vetvete
23 një dëshmi e nevojës për ta fuqizuar këtë institucion, që t'i
24 mbrojë dëshmitarët dhe viktimat.

25 Provat që do të japim, se të akuzuarit në fakt i kanë

1 shkelur secilën prej këtyre dispozitave, do ta bëjnë të qartë
2 përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka qenë synimi i tyre që ta
3 pengojnë këtë institucion dhe t'i detyrojnë dëshmitarët të
4 frikësohen.

5 Provat e kësaj çështjeje do të tregojnë se të akuzuarit
6 vepruan me synim kriminal dhe se veprimet dhe fjalët e tyre
7 nuk kishin qëllim legjitim apo ligjor. Për këtë dua të jem
8 shumë i qartë. Debati i gjallë mbi çështje të rëndësishme
9 publike është shenjë e një shoqërie të shëndetshme. Ai nuk
10 duhet mbytur, përkundrazi, sigurisht që duhet nxitur.

11 Ka në Kosovë njerëz të cilët besojnë fuqimisht te ky
12 institucion dhe që e konsiderojnë atë si një shenjë të
13 angazhimit të Kosovës për shtetin ligjor dhe si një vend ku
14 viktimave u jepet mundësia për të pasur drejtësi. Ka të tjerë
15 të cilët ende nuk kanë besim te kjo Gjykatë. Kjo është
16 normale. Është normale të vihen në dyshim aspekte të kësaj
17 Gjykate. Është normale të thuash se çfarë nuk të pëlqen nga
18 kjo Gjykatë dhe përse. Të gjitha këto janë pjesë të një
19 shoqërie të lirë.

20 Siç e kam thënë edhe më parë, unë të gjithë atyre që ende
21 nuk kanë besim te kjo Gjykatë, u kërkoj vetëm ta ndjekin me
22 vëmendje punën e saj, të shohin si funksionon dhe pastaj të
23 gjykojnë. Kam besim se nëse do të veprojmë kështu kanë për të
24 parë se ky institucion, një institucion i krijuar nga populli
25 i Kosovës, do të vendosë në vend drejtësinë për shumë e shumë

1 qytetarë të Kosovës.

2 Por ajo që nuk mund të bëhet në një shoqëri të lirë,
3 është të pengohet drejtësia. Nuk mund të përhapësh publikisht
4 informacione konfidenciale, informacione që përmbajnë emrat e
5 dëshmitarëve, e nuk mund të bëhet kjo me synimin e qartë për
6 t'i frikësuar dëshmitarët. E vërteta është themeli i
7 drejtësisë dhe ka disa të vërteta që shpjegojnë përse ndodhemi
8 këtu sot. Këto të vërteta e shpjegojnë çështjen gjyqësore që
9 paraqitet përpara Gjykatës dhe kontekstin, në të cilin të
10 akuzuarit i kanë kryer krimet për të cilat ngrihen akuzat.

11 E vërteta e parë. E vërteta e parë është se ekziston një
12 grup i vogël por i fuqishëm njerëzish në Kosovë të cilët nuk e
13 duan ekzistencën e kësaj Gjykate dhe të cilët do të bëjnë
14 gjithçka, gjithçka, për ta dëmtuar. Por pa pasur sukses në
15 orvatjen e tyre për ta shpëtuar idenë e rreme se asnjë ushtar
16 i UÇK-së nuk ka kryer krime gjatë luftës.

17 Siç e dinë mirë ata që janë kundër kësaj Gjykate,
18 çështjet e paraqitura nga Zyra që unë drejtoj, me faktet,
19 faktet që do të dalin në dritë në gjyqet e zhvilluara në këtë
20 sallë, nuk do të lënë asnjë dyshim se kjo ide nuk është e
21 vërtet. Por kjo ide e rreme është aq e rëndësishme sa që disa
22 udhëheqës të caktuar të UÇK-së do të bëjnë çmos, gjithçka që
23 të pengojnë daljen e në dritë të informacioneve që tregojnë që
24 kjo është e vërtetë.

25 Këta të akuzuar janë pjesë e këtij grupi dhe duan që kjo

1 Gjykatë të çmontohet me çdo mënyrë. Zoti Gucati dhe zoti
2 Haradinaj janë kundërshtarët të zëshëm të këtij institucioni
3 duke denigruar këdo që do ta njihte apo do të bashkëpunonte me
4 Dhomat e Specializuara të Kosovës apo me Zyrën e Prokurorit të
5 Specializuar, si spiunë, kolaboracionistë dhe tradhtarë që
6 kanë tradhtuar bashkatdhetarët, pavarësisht nga fakti se ky
7 është një institucion që është krijuar nga populli i Kosovës,
8 për popullin e Kosovës.

9 Një tjetër e vërtetë është se institucioni ynë nuk mund
10 të punojnë efektivisht në përmbushje të detyrës së vet nëse
11 viktimat dhe dëshmitarët janë aq të frikësuar saqë nuk
12 bashkëpunojnë. Ky, të nderuar Gjykatës, është një realitet i
13 vështirë por është gjithsesi një realitet. Një realitet të
14 cilin të akuzuarit e njohin mirë. Ne si institucion duhet jo
15 vetëm t'i mbrojmë dëshmitarët por duhet të ngjallim tek ata
16 edhe besimin se mund t'i mbrojmë.

17 Të akuzuarit e dinë këtë dhe siç do ta tregojnë edhe
18 provat në këtë gjyq, synimi i tyre ishte të nxirrnin
19 informacion konfidencialë për t'u hakmarrë kundër
20 dëshmitarëve, ngaqë kanë bashkëpunuar me Zyrën që unë drejtoj,
21 dhe për të mbjellë mosbesim te ky institucion dhe te aftësia e
22 tij për t'i mbrojtur dëshmitarët. Zoti Haradinaj nuk ka lënë
23 dyshim për këtë kur më 20 shtator të vitit që shkoi gjatë
24 kryerjes së krimeve për të cilat ngrihen akuzat, ai iu drejtua
25 drejtpërdrejtë dëshmitarëve në një program televiziv duke

1 thënë dhe - "ju spiunë, mos kujtoni se ka për t'ju mbrojtur
2 kush". Më pas ai shtoi se "Gjykata ka për të rënë totalisht
3 sepse edhe dëshmitarët tani e dinë se të tjerët e dinë se kush
4 janë ata".

5 Të nderuar Gjykatës, kjo Gjykatë duhet të ketë në
6 vëmendje viktimat dhe synimi i sjelljes së të akuzuarve ka
7 qenë tu shtjeri frikë viktimave. Për ta kuptuar plotësisht
8 përse të akuzuarit mendonin se mund ta bënin këtë përmes
9 veprimeve të tyre, duhet kuptuar konteksti në të cilin kanë
10 ndodhur veprimet e tyre, përfshirë presionet e ndjera nga
11 shumë dëshmitarë për të mos dalë të -- thënë të vërtetën. Pra
12 ato që kanë parë e kanë përjetuar gjatë luftës.

13 Një pjesë e arsyes përse është krijuar kjo Gjykatë dhe
14 sigurisht përse është vendosur këtu në Hagë, ka qenë atmosfera
15 e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrja në proces që
16 ekziston në çështjet penale kundër ish anëtarëve të UÇK-së.
17 Kjo atmosferë vijon të ekzistojë edhe sot dhe ka qenë plani i
18 të akuzuarve që ta intensifikojnë këtë atmosferë në mënyrë që
19 dëshmitarët të kenë frikë për të bashkëpunuar dhe për t'i
20 dhënë fund bashkëpunimit me këtë Gjykatë.

21 Është realitet që kjo atmosferë ka funksionuar më parë
22 duke i penguar dëshmitarët që të mos vijë në Gjykatë për të
23 treguar çfarë dinin për krimet e UÇK-së. Të akuzuarit e dinë
24 mirë këtë histori dhe kanë shpresuar ta përdorur të njëjtën
25 strategji këtu për t'i frikësuar dëshmitarët sepse ka

1 funksionuar edhe në të shkuarën.

2 Sa i takon akuzave në këtë çështje gjyqësore, dua të
3 sqaroj se për çfarë ngrihet dhe për çfarë nuk ngrihet akuzë në
4 këtë çështje. Përhapja në publik e dokumenteve konfidenciale
5 në fjalë në këtë çështje pra, përbën një grup krimesh.
6 Vjedhja e këtyre dokumenteve përbën një grup tjetër krimesh.

7 Të akuzuarit akuzohen për shpërndarje të paligjshme të
8 këtyre dokumenteve, por jo për vjedhjen e tyre. Që të jemi
9 shumë të qartë, jemi duke hetuar aktivisht vjedhje dokumenteve
10 në fjalë të kësaj çështjeje dhe kur të kemi grumbulluar prova
11 të mjaftueshme kundër personave që e kanë bërë, këta individë
12 do të arrestohen dhe do të dalin në këtë sallë gjyqi për t'u
13 përballur me akuzat për krimet e tyre. Duke qenë se bëhet
14 fjalë për një hetim të veçantë dhe konfidencial që është duke u
15 zhvilluar, nuk do të përmend sot asnjë prej hollësive në
16 lidhje me ecurinë e tij.

17 Por dua të bëj diçka krejt të qartë për të gjithë: nëse
18 kryen krime me qëllim ndërhyrje të dëshmitarit apo hakmarrje
19 kundër dëshmitarëve, kanë për të rënduar mbi ty akuzat. Lidhur
20 me këtë, Zyra që unë drejtoj, nuk do të pushojë asnjë çast.
21 Këtë duhet ta bëjmë për hir të viktimave dhe të dëshmitarëve
22 që besojnë se ky institucion do të vendosë në vend drejtësinë.

23 Të akuzuarit, me këto krime, janë përpjekur të
24 përforcojnë dëmin e shkaktuar prej tyre duke i shtyrë mediat e
25 Kosovës të publikojnë dhe të përhapin më tej materialin

1 konfidencial në fjalë. Në fakt, provat do të tregojnë se me të
2 marrë secilën paketë të materialit, ata thirrën me ngut një
3 konferencë për shtyp mu për këtë qëllim. Videot e këtyre
4 konferencave për shtyp do të paraqiten gjatë këtij gjyqi si
5 prova të pakundërshtueshme të krimeve dhe të synimit kriminal
6 të të akuzuarve.

7 Menjëherë pas ngjarjeve që përbëjnë bazën e kësaj
8 çështjeje gjyqësore, dola me një deklaratë publike për të
9 lëvduar etikën e gazetarëve kosovarë që nuk pranuan t'i
10 publikonin dokumentet të cilat ua vunë në dispozicion të
11 akuzuarit. Disa prej të cilëve në forume të ndryshme e pranuan
12 publikisht se pjesëmarrja në përhapjen e një informacioni të
13 tillë ishte krim.

14 Po këta gazetarë, si dhe të tjerë në Kosovë, kanë folur
15 me elokuencë se si aktivitete të tilla e cenojnë shtetin
16 ligjor dhe vënien në vend të drejtësisë në Kosovë. Sot i
17 falënderoj përsëri gazetarët me etikë të Kosovës. Në planet e
18 tyre, të akuzuarit nuk e kanë llogaritur mirë se si do ta
19 trajtonte këtë ngjarje media e Kosovës.

20 Do të paraqesim prova se si të akuzuarit, në veçanti zoti
21 Haradinaj, i ka kritikuar punonjësit e mediave pse nuk kanë
22 publikuar më shumë nga materiali që të akuzuarit synonin t'u
23 vinin në dispozicion. Megjithëse të akuzuarit kishin shpresuar
24 që të gjitha media do t'i publikonin emrat dhe të dhënat
25 personale të dëshmitarëve dhe se do të frikësoheshin këta që

1 të mos bashkëpunonin me këtë Gjykatë, kjo në fakt nuk ndodhi.
2 Publiku, kjo Gjykatë dhe të akuzuarit duhet ta dinë se
3 përpjekjet e tyre për ta ndaluar këtë institucion kanë
4 dështuar.

5 Veprimi i të akuzuarve në të vërtetë e pengoi rëndë Zyrën
6 që unë drejtoj dhe e detyroi stafin që unë drejtoj të heqë një
7 pjesë të mirë të burimeve për t'u dhënë përgjigje veprimeve të
8 tyre, duke i penguar rëndë hetimet e Zyrës që unë drejtoj.
9 Veprimet e të akuzuarve ngjallën vërtetë frikë dhe ankth në
10 dëshmitarë dhe viktimë në mbarë Kosovën dhe gjetkë.

11 Por më në fund përpjekjet e tyre për ta penguar ecjen
12 drejtë drejtësisë, përpjekjet e tyre për të shkaktuar rënie të
13 plotë të këtij institucioni, dolën të pa frytshme. Fakti që
14 nuk e arritën objektin e tyre fundor nuk i bën më pak fajtorë
15 për krimet për të cilat akuzohen. Fakti që nuk patën mundësinë
16 ta mbyllin këtë Gjykatë, nuk ja ul aspak rëndësinë synimit të
17 me të cilin kanë vepruar dhe pasojat reale që patën për
18 dëshmitarët dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

19 Të akuzuarit e nënvlerësuan fuqinë dhe forcën e këtij
20 institucioni dhe të njerëzve që punojnë këtu, njerëz të cilët
21 i janë përkushtuar misionit të drejtësisë. Më me rëndësi, ata
22 e nënvlerësuan shumë vullnetin dhe guximin e njerëzve të
23 Kosovës që kanë bashkëpunuar me këtë Gjykatë, njerëz që ka 20
24 vjet që presin drejtësinë.

25 Ju falënderoj të nderuar Gjykatës që më dhatë mundësinë

1 t'ju drejtohem sot. Do t'ja jap tani fjalën Prokurores Bolici,
2 që do t'u paraqesë të nderuarve Gjykatës dhe publikut më shumë
3 hollësi për çështjen tonë dhe sesi Zyra e Prokurorit të
4 Specializuar do të provojë se të akuzuarit mbajnë përgjegjësi
5 individuale për krimet me të cilat akuzohen.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 zoti Smith.

8 Zonja Bolici, keni fjalën.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Siç sapo e dëgjuat nga fjalët e Prokurorit të
12 Specializuar, kjo çështje ka të bëjë me dy persona: Hysni
13 Gucati dhe Nasim Haradinaj, të cilët ishin kaq të vendosur ta
14 kundërshtonin atë që përfaqëson kjo Gjykatë, sa që ishin të
15 gatshëm të kryenin krime në orvatje për ta cenuar dhe madje
16 për ta ndaluar punën e saj.

17 Provat do të tregojnë se në orvatje për ta ndaluar vënien
18 në vend të drejtësisë në këtë Gjykatë vetë të akuzuarit e
19 shkelin ligjin. Për 19 ditë gjatë muajit shtator të vitit
20 2020, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj shpërndanë në mënyrë të
21 përsëritur informacione konfidenciale të Task-Forcës Hetimore
22 Speciale për Kosovën dhe të Zyrës së Prokurorit të
23 Specializuar, me qëllimin e vetëm pengimin e punës së kësaj
24 Gjykate përmes frikësimit të dëshmitarëve dhe hakmarrjes ndaj
25 tyre.

1 Prova do të tregojnë se të akuzuarit e dinin se çfarë po
2 bënin në çdo hap, se vepruan me dashje dhe se vijuan t'i
3 kryenin krimet edhe atëherë kur ju tha se po shkelnin ligjin.

4 Historia e kësaj çështjeje gjyqësore fillon mëngjesin e
5 datës 7 shtator 2020, kur një njeri i paidentifikuar hyri në
6 zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së në
7 Prishtinë, prej nga doli pas disa çastesh, duke lënë aty një
8 kuti kartoni. Gjatë rreth tre orëve që vijuan, zoti Gucati dhe
9 z. Haradinaj gjetën me qindra faqe dokumentesh kondifidenciale
10 që u përkisnin krimeve të TFHS-së. I shfletuan këto dokumente,
11 bënë një vlerësim të hollësishëm të llojeve të informacioneve
12 që përmbanin dokumentet dhe e kuptuan që këto dokumente ishin
13 konfidenciale.

14 Atëherë a e kontaktuan të akuzuarit Zyrën e Prokurorit të
15 Specializuar për t'i treguar se u kishin ardhur dokumente
16 konfidenciale? Jo. A ju drejtuan Gjykatësve të kësaj Gjykate
17 për t'i treguar për dokumentet apo po policisë së Kosovës? Jo.
18 A bënë ndonjë hap për të bërë raportim në ndonjë autoritet se
19 u kishin ardhur dokumente konfidenciale? Jo. Nuk bënë asnjërin
20 prej këtyre hapave.

21 Por çfarë bënë ata? Menjëherë organizuan një konferencë
22 për shtyp, për t'i bërë dokumentet publike, për t'i shpërndarë
23 sa më shpejt përpara se të mund t'i ndalonte kush. Thirrën
24 mediat në zyrat e tyre dhe afërsisht tre orë pas ardhjes së
25 dokumenteve, zhvilluan një konferencë për shtyp, ku i

1 prezantuan. E gjitha kjo është regjistruar me video, siç janë
2 të regjistruara me video edhe konferencat e mëpasshme për
3 shtyp, që do të thotë, të nderuar Gjykatës, se krimet për të
4 cilat ngrihen akuzat, janë kryer përpara kamerave.

5 Do të keni mundësi të shini me sytë tuaj të dy të
6 akuzuarit tek i kryenin krimet për të cilat ngrihen akuzat në
7 këtë çështje.

8 Të fillojmë me disa pamje nga konferenca e parë për
9 shtyp, nga materiali 12 i listës së provave të ZPS-së. Ftojme
10 personat e pranishëm të ndjekin në kanalën e provave dhe
11 kërkoj edhe konfirmim nga Sekretarja e Gjykatës nëse mund të
12 vazhdoj apo jo.

13 Këtu, të nderuar Gjykatës, shihen dy të akuzuarit së
14 bashku me sekretarin e OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, tek i
15 vendosin në dispozicion shtypit -- do të pres sa të zgjidhet
16 problemi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Kjo pauzë bëhet për shkak të një problemi teknik.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdojmë tani zonja Bolici.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

23 Pra, në këtë fotografi të parë është shkëputur nga
24 konferenca e parë për shtyp që është materiali 12 i listës së
25 provave të ZPS-së. Këtu shihen të dy të akuzuarit së bashku me

1 sekretarinë e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së,
2 Faton Klinaku, tek i vendosin në dispozicion shtypit
3 dokumentet e ardhura konfidenciale.

4 Në këtë fotografi tjetër të shkëputur prej kësaj
5 konference është Hysni Gucati që mban në dorë dokumentet për
6 tua treguar mediave.

7 Në këtë fotografi tjetër që është marrë nga materiali 249
8 i listës së provave të ZPS-së është Nasim Haradinaj që
9 shfleton dokumentet ndërsa mediat bëjnë foto edhe video.

10 Çfarë u thoshin të akuzuarit mediave ndërsa ua
11 shpërndanin dokumentet dhe i bënë publike? Ajo se çfarë
12 thoshin tregon se ata e dinin mirë se çfarë po bënë, se çfarë
13 kishin në dorë, e dinin se këto dokumente i përkisnin një
14 hetimi penal të këtij institucioni dhe e dinin se ishin
15 konfidenciale. Me gojën e tyre e bënë të qartë që kishin:
16 frikësimin e dëshmitarëve, t'u fusnin atyre frikën, të merrnin
17 hak kundër tyre, të cenonin punën e kësaj Gjykate.

18 Duhet t'i shohim më nga afër fjalët e tyre sepse janë të
19 rëndësishme. Së pari, Nasim Haradinaj, me Hysni Gucatin në
20 krah, u tha mediave se këto dokumente ishin konfidenciale dhe
21 top sekret dhe sigurisht që e dinin këtë. I kontrolluan
22 dokumentet, e kuptuan shumë mirë që i përkisnin një hetimi
23 penal të kryer nga ky institucion dhe i vlerësuan dokumentet
24 si konfidenciale. Dhe ky vlerësim ishte i saktë. Të nderuar
25 Gjykatës, gjatë këtij gjyqi do të dëgjoni dëshmi për natyrën

1 konfidenciale të këtyre dokumenteve.

2 Së dyti, zoti Haradinaj vijoi të thoshte se mund t'i
3 kishin mbajtur edhe sekret dokumentet, por kishin vendosur t'i
4 bënin publike. Pjesët e mëposhtme janë nga transkriptimi i
5 konferencës së parë për shtyp që përkon me materialin 11 të
6 listës së provave të ZPS-së:

7 "...po të kishim dashur mund të mos i kishim bërë fare
8 publike".

9 Zoti Haradinaj u thotë gjatë konferencës për shtyp
10 mediave se si dhe i bashkë-akuzuari mund t'i kishin mbajtur të
11 fshehta dokumentet, porse kishin vendosur t'i bënin publike.
12 Vendimin e morën ata.

13 Së treti, zoti Haradinaj u tha mediave të mbledhura aty
14 se çfarë përmbanin dokumentet dhe përsëri nga i njëjti
15 transkriptimi po lexoj:

16 "...këto janë emrat e të gjithë dëshmitarëve që thonë se
17 janë nën mbrojtjen e tyre. Të gjithë."

18 Dhe ai vijon të thotë: "... si mund të garantosh
19 mbrojtjen dëshmitarëve kur të gjithë mund t'i lexojnë këto
20 sot".

21 Këto fjalë të z. Haradinajt u drejtoheshin dëshmitarëve
22 që i kishin dhënë informacion, prova, dëshmi pra, TFS-së apo
23 ZPS-së për t'i bërë të ndihen të ekspozuar, të rrezikuar e të
24 pa mbrojtur. Ai i nxiti të pranishmit në konferencën për shtyp
25 t'i shihnin dokumentet e t'i merrnin me vete. U tha mediave se

1 dokumentet përmbanin të gjitha të dhënat sekrete për
2 dëshmitarët, përfshirë emrat dhe mbiemrat e shqiptarëve,
3 romëve dhe serbëve që përmbanin datën se kur ishte
4 intervistuar secili person, dhe vendndodhjen e intervistës.

5 Dhe ai vazhdoi më tej duke zbuluar emrat dhe profesionet,
6 vendet e punës pra, të disa personave të veçantë që kishin
7 bashkëpunuar me ZPS-në. Madje, duke shkuar deri aty sa të
8 zbulojë edhe se ku banonin disa prej këtyre personave.

9 Le t'i shohim tani të akuzuarit në veprim sepse siç e
10 thashë gjithçka që kanë bërë është kapur nga kamerat. Kjo
11 pjesë filmike nxjerrë nga materiali 12 i listës së provave të
12 ZPS-së, tregon sesa mirë i njihnin të akuzuarit dokumentet
13 konfidenciale të cilat po i bënin publike dhe sa me kujdes i
14 kishin parë dokumentet përpara se tua tregonin të tjerëve. Do
15 të shfaqim disa video sot, me audion origjinale në gjuhën
16 shqipe po ka titra në anglisht, nuk ka nevojë që të përkthehet
17 në anglisht ajo çfarë thuhet në shqip, që të mos ketë
18 mbivendosje. Ftojme Trupin Gjykses dhe të pranishmit që të
19 ndjekin kanalin e provave.

20 [Shfaqet video]

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Atëherë le ta përsëris edhe një
22 herë atë çfarë dëgjuam, z. Haradinaj të thoshte:

23 "Këto emra, këto mbiemra, tani duhet ta dinë që ata janë
24 emra të njohur dhe se askush nuk është i panjohur, sepse emrat
25 ekzaktë, deklaratat e sakta, rideklaratat të cilat i kanë

1 dhënë personat, apo deklaratat e tjera që ata kanë dhënë,
2 tashmë janë të gjitha të treguara këtu”.

3 Atëherë vini re detajet në përshkrimin dhe mesazhet që
4 dërgon ai, pra mesazhe që ju dërgon dëshmitarëve. Askush nuk
5 është i panjohur. Ata janë të ekspozuar. Dhe ai nuk përfundoi
6 me deklaratën e parë për shtyp. Më pas, i akuzuari doli në
7 shumë programe televizive për t’u siguruar që përmbajtja e
8 dokumenteve do të vazhdonte të ishte e njohur në mënyrë të
9 tillë që të mund të bëheshin kërcënimet të tjera kundër
10 dëshmitarëve.

11 Në një shfaqje të tillë, e cila është transmetuar disa
12 orë pas konferencës për shtyp, me datë 7 shtator 2022, Hysni
13 Gucati e bëri të qartë që ai kishte njohur disa prej emrave të
14 personave që kishte parë në dokumente që kishte bërë publik më
15 herët atë ditë.

16 Tani do t’ju tregoj një fragment të shkurtër nga
17 dokumenti 34 i listës së provave materiale të ZPS-së.

18 [Shfaqet video]

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ajo çfarë thuhet: “Unë që kemi
20 parë shumë gjind, të cilët kemi besu n’ta”. Pra mesazhi
21 kërcënues i cili përmbahet në këtë formulim, duket edhe më
22 qartë duke pasur parasysh që në të njëjtën rast, Hysni Gucati
23 i etiketoi ata të cilët kanë bashkëpunuar me ZPS-në si
24 “tradhtarë të vendit tonë”.

25 Gjatë të njëjtës dëshmie, Hysni Gucati pra vendosi të që

1 vazhdonte pra me vendimin e tij për të bërë publike këto
2 dokumente. Ndërkohë i pyetur në qoftë se ishte ide e mirë që
3 këto dokumente të bëheshin publike, Gucati tha që besonte që
4 ky ishte një vendim i mirë dhe ky vendim ishte i diskutuar me
5 komitetin dhe me personat të tjerë. Kur i intervistuari [siç u
6 përkthye] vërejti që gjëra të caktuara mund të ndodhnin sepse
7 emrat përmbanin emra, Gucati e pranoi që mund të ndodhnin
8 gjëra të caktuara.

9 Ndërkohë, në datën -- një ditë më pas, më 8 shtator 2020,
10 ZPS-ja konfiskoi një pjesë të dokumenteve që i akuzuari kishte
11 në zotërim të tij dhe siç mund ta shihni nga dokumenti 340 i
12 listës së provave materiale të ZPS-së, urdhri udhëzoi Hysni
13 Gucatin, OVL-UÇK-në dhe individë të tjerë në zotërim të
14 dokumenteve dhe/ose përmbajtjes së tyre, që të mos kopjonin
15 dhe të mos i shpërndanin më tej ato dhe përmbajtjen e tyre.

16 Megjithatë, siç do ta dëshmojmë përmes provave, ky urdhër
17 nuk i ndaloi të akuzuarit, pasi të akuzuarit vazhduan të bënin
18 thirrje për shpërndarjen e materialit dhe po ashtu, dhanë dhe
19 ofruan dokumente edhe më tepër konfidenciale për OVL-UÇK-në,
20 në mënyrë që këto materiale të mund t'i bënin edhe ato
21 publike.

22 Në ekranet tuaja është dokumenti 420 i listës së provave
23 materiale të ZPS-së. Është një postim i llogarisë së Facebook-
24 ut të Nasim Haradinajt me datë 8 shtator 2020. Poshtë postimit
25 të tij, së bashku me ofrimin e dokumenteve konfidenciale të

1 OVL-UÇK-së një ditë më përpara, Nasim Haradinaj komenton: "Ato
2 nuk mund t'i bëjnë më të padukshëm këto materiale". Po ashtu
3 ai njoftoi që janë dhënë edhe tre kopje të tjera dhe këto
4 kopje janë shpërndarë në dhjetë vende të tjera dhe se është
5 detyra e këtyre dhjetë vendeve të tjera që të vijonin me
6 shpërndarjen e mëtejshme të tre kopjeve.

7 Pra ai i inkurajon dhe pranon vijimësinë e dhënies së
8 shpërndarjes së informacionit konfidencial.

9 Ndërkohë i akuzuari vijon që të dalë në emisione të tjera
10 televizive. Ndërkohë që videoja që do të shikojmë, fragmenti
11 që do të shikojmë, që është pjesë e dokumentit 100 të listës
12 së provave materiale të ZPS-së është njëri prej këtyre rasteve
13 kur zoti Haradinaj del në një program televiziv në datën 11
14 shtator 2020.

15 [Shfaqet video]

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ai thotë: "Sa herë na vjen një
17 kësi lloj materiali, ne do ta bëjmë publik" dhe z. Haradinaj
18 dëshiron që të shkojë më tej, të marrë më shumë dokumente, të
19 vazhdojë që të kryejë veprime të pengimit të drejtësisë dhe
20 frikësimit të dëshmitarëve për të minuar punën e kësaj
21 Gjykate.

22 Dhe në fakt nuk kaloi shumë kohë deri sa angazhimi i z.
23 Haradinaj për më shumë informacione konfidenciale vijojti më
24 tej. Herët pasdite, më datë 16 shtator 202, një person i
25 [pa]identifikuar sërish shkoi në OVL-UÇK. Në këtë rast duke

1 mbajtur disa kuti kartoni, të cilat ai i la në tokë përpara se
2 të largohej.

3 Dhe çfarë bëri i akuzuari? I akuzuari bëri ekzaktësisht
4 çfarë bëri herën e parë. Pavarësisht urdhrit gjyqësor që ishte
5 lëshuar radhën e parë, ata shumë shpejt organizuar një tjetër
6 konferencë për shtyp për të ndarë edhe këtë grup dokumentesh.
7 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj përdorën rastin e konferencës
8 së dytë për shtyp për të bërë thirrje edhe njëherë ata që
9 ishin të pranishëm për të marrë dokumentet. Ata thanë dhe
10 treguan gjëra të cilat janë të regjistruar në video se ka tre
11 kopje të disponueshme për shtypin me qindra faqe secila. Edhe
12 një herë, informacioni konfidencial i nxjerrë përfshinte emrat
13 e personave që kishin bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara,
14 vendet me interes për hetimet e THFS-së dhe të ZPS-së.

15 Edhe një herë Nasim Haradinaj përsëri dha premtimin e tij
16 për të bërë publik dokumentet kurdoherë që OVL-UÇK-ja do t'i
17 merrte këto dokumente dhe vërejtji që ishte detyra e tij dhe
18 detyra e OVL-UÇK-së që të diskreditonte Gjykatën e
19 Specializuar dhe se kjo ishte arsyeja sepse OVL-UÇK-ja do të
20 vazhdonte që të shpërndante dokumentet.

21 Të nesërmen, më 17 shtator 2020, sërish në pajtim me një
22 urdhër të Gjykatës, ZPS-ja konfiskon dokumentet që i akuzuari
23 kishte ende në zotërim të tij. Edhe një herë urdhri udhëzoi të
24 gjithë ata që zotëronin dokumentet që të ndalonin shpërndarjen
25 e mëtejshme të këtyre dokumenteve ose të përmbajtjeve të tyre.

1 Dokumentet e marra në këtë rast, të cilat ishin goxha më
2 pak se sa numri i faqeve që të akuzuarit i kishin bërë të
3 disponueshëm për shtypin, pra përbëheshin kryesisht nga
4 materiale publikisht i disponueshëm. Megjithatë, gjashtë faqe
5 janë identike me faqet të cilat janë marrë më 8 shtator 2020,
6 përfshirë këtu referencat ndaj tre dëshmitarëve dhe
7 dëshmitarëve potencialë dhe referenca të datave të lindjes, së
8 funksioneve profesionale të këtyre personave.

9 Vetë fjalët e thëna nga të akuzuarit në këtë konferencë
10 për shtyp edhe një herë mbështesin kërcënimet ndaj
11 dëshmitarëve. Kërcënime të cilat po përforcoheshin dhe po
12 përsëriteshin.

13 Siç mund të shikoni nga dokumenti që është shfaqur në
14 ekranin tuaj, i cili është dokumenti 5 në listën e provave
15 materiale të ZPS-së, Hysni Gucati e nënshkroi këtë dokument
16 duke njohur konfiskimin.

17 Siç u bë edhe pas konferencës së parë për shtyp, i
18 akuzuari bëri disa shfaqje të tjera në programet televizive
19 pas 16 shtatorit, pra pas konferencë për shtyp të 16
20 shtatorit. Do të dëgjojmë Nasim Haradinajn në një prej këtyre
21 programeve, të njëjtën ditë kur është mbajtur konferenca e
22 dytë për shtyp. Ai pranon haptazi dëshirën e tij për të
23 dëmtuar procesin gjyqësor dhe për të penguar drejtësinë për
24 mes veprimeve të tij.

25 Le të shohim klipin e parë nga dokumenti 100 në listën e

1 provave materiale të ZPS-së.

2 [Shfaqet video]

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I pyetur në qoftë se ishte i
4 vetëdijshëm që çdo gjë që po ndodhte mund të dëmtonte procesin
5 gjyqësor, z. Haradinaj u përgjigj që "ky është qejfi jem" dhe
6 ai vazhdoi siç tregohet në klipin pasardhës nga e njëjta
7 video.

8 [Shfaqet video]

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëmtim i procesit gjyqësor. Kjo
10 është ajo çfarë dëshironte z. Haradinaj. Ndërkohë që lidhur me
11 pengimin e drejtësisë kur i takon kësaj Gjykate, ai do ta bëjë
12 këtë gjë për gjithë jetën e vet.

13 Tani le të dëgjojmë pak z. Gucati me datën 17 shtator
14 2020. Ky fragment nga dokumenti 19 i listës së provave
15 materiale të ZPS-së, është vetëm një shembull i shumë
16 deklaratave publike të kësaj natyre të bëra nga të akuzuarit
17 gjatë këtyre ditëve dhe të gjitha ato u janë parashtruar, të
18 nderuar Gjykatës, për juve për t'i ri shqyrtuar dhe për t'i
19 gjykuar. Vini re se çfarë thotë z. Gucati lidhur me atë se
20 çfarë është urdhëruar nga Gjykata dhe se si, pavarësisht
21 kësaj, ai nuk do ta respektoj këtë urdhër. Këto janë fjalët e
22 z. Gucati.

23 [Shfaqet video]

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] "Ata më thanë qartë se këto
25 dokumente nuk mund të shumëzohen, nuk mund të shpërndahen apo

1 emrat e dëshmitarëve nuk mund të botohen”.

2 Pra z. Gucati e kuptoi që ai ishte urdhëruar të mos i
3 shpërndante dokumentet, megjithatë ai nuk ndaloi.

4 Siç e thashë edhe në fillim farë të kësaj deklarate
5 hapëse, ai ishte kaq i vendosur për të minuar punën e kësaj
6 Gjykate sa ishte i gatshëm të mos respektonin një urdhër
7 gjyqësor, i gatshëm për të thyer ligjin, për të frikësuar
8 dëshmitarët dhe për të penguar punën e kësaj Gjykate. Dhe kjo
9 vijon më tej.

10 Fragmenti që do të tregojmë tani, që vjen nga dokumenti
11 55 i listës së provave materiale të ZPS-së, është një shfaqje
12 disa ditë më pas e z. Haradinajt, me datë 20 shtator 2020.
13 Dëgjoni fjalët që ai përdor për të kërcënuar dëshmitarët dhe
14 dëgjoni se çfarë thotë lidhur me synimin e tij për t’i bërë
15 publike këto dokumente.

16 [Shfaqet video]

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ai i drejtohet atyre të cilët
18 kanë dhënë informacion lidhur me hetimet e kësaj Gjykate si
19 kriminelë dhe gjakpirës dhe ai vijon më tej dukë thënë si më
20 poshtë.

21 [Shfaqet video]

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ai i drejtohet dëshmitarëve si
23 qyqana, budalla dhe spiunë dhe se askush asnjëherë nuk i
24 kishte mbrojtur personat të tillë, por në të kundërtën,
25 spiunët ishin vrarë diskretituar ose anashkaluar.

1 Edhe një herë z. Haradinaj vijon kësaj here duke e bërë
2 të qartë synimin e tij shumë në mënyrë të dukshme.

3 [Shfaqet video]

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Duke ju referuar kësaj Gjykate,
5 ai tha që Gjykata do të rrëzohet krejt, sepse dëshmitarët tani
6 e dinë që të tjerët e dinë që kush janë këta dëshmitarë.

7 Dhe së fundi, nga e njëjta video:

8 [Shfaqet video]

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Me këto fjalë z. Haradinaj në
10 mënyrë të qartë shpjegon se qëllimi i tij është që të
11 frikësojë dëshmitarë në mënyrë që të rrëzojë Gjykatën.
12 Pavarësisht prej urdhrave të Gjykatës, ai vazhdon që të
13 kërkojë më shumë informacion konfidencial në mënyrë të tillë
14 që të mund të vijojë me shpërndarjen e këtij informacioni po
15 ashtu. Ndërkohë i akuzuari vazhdon që të postojë dokumentet
16 konfidenciale në median sociale. Dokumenti 120 nga lista e
17 provave materiale të ZPS-së që tani është në ekran, është një
18 postim i bërë me 21 shtator 2020, i botuar në llogarinë në
19 Facebook të z. Hsyni Gucati, ku deklarohej se dosjet të cilat
20 i janë dorëzuar OVL së UÇK-së ishin dokumente zyrtare të
21 Gjykatës Speciale që përfshinin emrat e pjesës më të madhe të
22 dëshmitarëve.

23 Ai i referohet dokumenteve që kanë ardhur nga zyrat e
24 Zyrës -- e Gjykatës së Specializuar si shumë konfidenciale dhe
25 sensitive.

1 Hysni Gucati deklaroi se:

2 "Dosjet përfshijnë deklaratatë të bëra nga dëshmitarët
3 kundër UÇK-së" dhe se "njerëzit të cilët kanë zgjedhur që të
4 dorëzojnë dosjet tek OVL-UÇK-ja kishin si synim që të krijojnë
5 një barrë me një përgjegjësi të madhe për të..."

6 Megjithatë, ashtu siç do të tregohet edhe nga pjesa
7 tjetër e deklaratës hapëse nga zoti Pace, kryerja e krimeve e
8 të akuzuarve nuk është se ka përfunduar pas këtyre dy
9 konferencave për shtyp me datë 7 dhe 16 shtator. Kjo nuk i
10 ndaloi të akuzuarit që të merrnin pjesë në shumë programe
11 televizive dhe që të postonin postime të shumta në mediat
12 sociale në periudhën nga data 7 deri në 21 shtator. Në vend të
13 kësaj ata vijuan me modelin e sjelljes kriminale deri në ditën
14 e arrestit të tij.

15 Tani më lejoni t'i jap fjalën kolegut tim, Z. Pace.

16 Z. PACE: [Përkthim] Përshëndetje, të nderuar Gjykatës.

17 Sa i takon kohës, e kuptoj që seanca do të vazhdojë deri
18 në orën 13.00 dhe unë mendoj se do ta përfundoj prezantimin
19 tim deri në atë kohë.

20 Siç u tregua edhe prej koleges sime unë do të vazhdoj
21 t'ju shpjegoj aktivitetet kryesore të cilat janë pikat
22 kryesore të akuzave në akt-akuzë, në veçanti ngjarje që kanë
23 ndodhur nga 22 shtatorit e në vijim.

24 Rrethi orës 10.30 të mëngjesit të datës 22 shtator 2020,
25 një individ i paidentifikuar sërish shkoi në ambientet e OVL

1 së UÇK-së në Prishtinë dhe dha një grup tjetër dokumentesh.
2 Edhe njëherë të akuzuarit nuk morën asnjë hap për të njoftuar
3 autoritete rreth këtyre dokumenteve, por në vend të kësaj ata
4 vepruan në mënyrë të shpejtë për t'i bërë këto dokumente
5 publike.

6 Në fakt, më pak se sa dy për pas dhënies së dokumenteve,
7 Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj organizuan një konferencë të
8 tretë për shtyp, gjatë së cilës ata i ftuan personat e
9 pranishëm që të shikonin dhe të lexonin dokumentet, të bënin
10 kopje të tyre dhe t'i botonin përmbajtjet e tyre.

11 Pamja që -- fotografia që keni përpara nga dokumenti 126
12 i listës së provave materiale duket një pamje e njohur. Është
13 organizimi i ngjashëm si në dy konferencat e tjera për shtyp.
14 Në këtë fotografi ju mund të shikoni Hysni Gucatin, Nasim
15 Haradinajn dhe Faton Klinakun me dokumentet që po i bëjnë
16 publike. Dokumentet janë përpara tyre. Siç ka deklaruar edhe
17 vetë z. Gucati në fillim të konferencës së tretë për shtyp,
18 dhe citoj këtu: "Duket sikur është bërë rutinë, zakon. Ne ju
19 kemi bërë ju gazetarë, ju kemi lodhur paksa juve gazetarëve,
20 duke ju ftuar këtu". Në fakt ishte bërë rutinë, ishte bërë
21 zakon një rutinë kjo e shkeljes së ligjit, e organizimit dhe
22 kryerjes së krimeve për të frikësuar dëshmitarët dhe për të
23 penguar Gjykatën.

24 Përpara sesa t'i jepte zëvendësit të tij, Hysni Gucati
25 tha që informacionet që kishte përpara përmbanin emrat e shumë

1 personave dhe ai theksoi edhe një herë mesazhin që e kishte
2 dhënë për publikun e përgjithshëm gjatë dy javëve të
3 mëparshme. Të akuzuarit po bënë publik emrat e personave që
4 kishin bashkëpunuar me ZPS-në. Ndërkohë që në ekran jepet ky
5 segment:

6 "...ne do t'ja bëjmë, do t'ja nxjerrim këto dokumente
7 njerëzve të Kosovës, vendit tonë dhe të gjithëve. Ne do të
8 tregojmë të vërtetën se këta këtu po mundohen që të
9 diskreditojnë UÇK-në me të gjitha mënyrat, porse nuk do t'ja
10 dalin asnjëherë ta bëjnë një gjë të tillë"...

11 Dhe në këtë fragment, nga dokumenti 159 zoti Gucati po
12 realizon premtimin ose synimin e tij për të dhënë emrat e
13 dëshmitarëve dhe për t'u siguruar që ky institucion nuk do
14 t'ja dalë, duke i treguar këta persona si armiq.

15 Kur zoti Haradinaj mori fjalën ai dha informacion të
16 ngjashëm, madje duke u futur në më tepër hollësi, ai dha të
17 njëjtin mesazh frikësues. Zoti Haradinaj e bëri të qartë që
18 ishte plotësisht i ndërgjegjshëm për natyrën e dokumenteve që
19 po bënte publike OVL-ja e UÇK-së. Ai vërejti se dokumentet
20 përpara tij kishin logon e ZPS-së dhe siç e kishte kuptuar ai,
21 ato përmbanin një projekt aktakuze në lidhje me pesë të
22 dyshuarit.

23 Ai i tha emrat e pesë të dyshuarve, njëri pas tjetrit si
24 dhe dha edhe emrat dhe shumë vendndodhje të cilat përmendeshin
25 në dokument. Asnjë prej këtyre informacioneve që lidhej me

1 vendet e krimeve të pretenduara nuk ishte publik në ato kohë
2 dhe i akuzuari e dinte që dokumentet ishin konfidenciale sepse
3 ato ishin qartazi të shënjuara si të tilla, siç do të tregojmë
4 edhe pak më vonë.

5 Zoti Haradinaj po ashtu theksoi se kishte detaje të shumë
6 personave të përmendur në dosje të tilla, siç kishte bërë edhe
7 kolegu i tij pak më parë. Zoti Haradinaj e përmendi njërin
8 prej këtyre emrave me zë të lartë dhe tha që kishte edhe emra
9 të shumë e shumë personave të tjerë në ato dokumente. Më pas
10 ai ftoi gazetarët që ishin të pranishëm që t'i lexonin
11 dokumentet vetë, i falënderoi ata se kishin qenë aktiv dhe ju
12 bëri thirrje atyre të bënë punën e tyre dhe të shpërndanin
13 informacionin të cilin ai po ua bënte -- po ua vinte në
14 dispozicion.

15 Zoti Gucati më tej theksoi se dokumentet ishin për median
16 dhe tha - dhe citoj këtu: "Dokumentet i keni përpara, ne ua
17 kemi dhënë tashmë këto dokumente". Ai po ashtu konfirmoi se 80
18 për qind e personave të cilët kanë dhënë prova të parashikuara
19 në këto dokumente, ishin shqiptarë. Kjo tregon, të nderuar
20 Gjykatës, se që në momentin që i akuzuari i dha medias këtë
21 grup të tretë dokumentesh konfidenciale, ata të dy ishin
22 plotësisht të ndërgjegjshëm që po jepnin informacion që lidhej
23 me emrat e individëve që e kishin dhënë prova, dëshmi ZPS-së.

24 Shumë shkëmbime në këtë konferencë për shtyp tregojnë që
25 jo vetëm që veprimet e të akuzuarit ishin të vullnetshme, por

1 që të akuzuarit ishin të vendosur që të kryenin veprime të
2 cilat ata i dinin që ishin sanksione penale dhe për të cilat
3 do të mbanin përgjegjësi penale.

4 Dua t'ju tregoj shkurtimisht dy fragmente nga dokumenti
5 160 i listës së provave materiale.

6 [Shfaqet video]

7 Z. PACE: [Përkthim] Ky është fragmenti i dytë nga e
8 njëjta video.

9 [Shfaqet video]

10 Z. PACE: [Përkthim] "Ne jemi gati që të vuajmë 300 vjet".
11 Fjalët e të akuzuarit nuk mund të jenë më të qarta sesa kaq.
12 Të akuzuarit e dinin që po shkelnin ligjin, megjithatë ishin
13 të gatshëm që të shkonin në burg në mënyrë që të pengonin
14 punën e Gjykatës.

15 Siç u tregua nga kolegja ime edhe më përpara, të
16 akuzuarit deri në këtë kohë ishin -- u ishte thënë disa herë
17 që dokumentet që ata kishin në posedimin e tyre ishin të
18 paligjshme dhe që përmbanin informacion konfidencial. Të
19 akuzuarit vetë kanë konfirmuar paralajmërimet që kishin marrë
20 më parë. Për shembull në konferencën e tretë për shtyp, kur
21 ata u pyetën në qoftë se i kishte thënë ZPS-ja që të mos
22 shpërndante grupin e dytë të dokumenteve, zoti Haradinaj dha
23 përgjigjen që do ta dëgjoni në videon që do të shfaqet tani.

24 [Shfaqet video]

25 Z. PACE: [Përkthim] "Ata na kërkuan që t'ua dorëzojmë

1 këto dokumente por ne ju thamë që nuk do të bashkëpunojmë me
2 ta. Po, po ata na thanë, por nuk e kemi dëgjuar. Ne nuk do t'i
3 dëgjojmë ata dhe nuk synojmë që t'i dëgjojmë ata".

4 Dhe këtë tha në fakt zoti Haradinaj në këtë fragment të
5 marrë nga dokumenti 160 i provave materiale.

6 Siç ka thënë z. Hysni Gucati edhe më herët në këtë
7 konferencë për shtyp, Nasim Haradinaj vijoi më tej duke
8 theksuar arsyet e të bashkë-akuzuarit për vazhdimin e shkeljes
9 së sekretit të procedurave dhe për frikësimin e dëshmitarëve
10 potencialë të mundshëm. Ai tha:

11 "Ne do të botojmë çdo gjë që do të marrim këtu dhe nuk do
12 të mbajmë asgjë sekret. Ne do të botojmë çdo gjë që do të
13 marrim që ekspozon këtë aktakuzë dhe aktakuzën që ata duan të
14 parashtrojnë" dhe ky është fundi i citimit.

15 Pjesa e fundit e kësaj konference për shtyp nga e njëjta
16 video tregon qartazi se si dokumentet në zotërim të të
17 akuzuarit u qasën nga persona të cilët ishin të pranishëm në
18 konferencën e tretë për shtyp. Le të shikojmë fragmentin.

19 [Shfaqet video]

20 Z. PACE: [Përkthim] Brenda orëve të konferencës për shtyp
21 të 22 shtatorit, ZPS-ja dha një urdhër duke udhëzuar Hysni
22 Gucatin dhe/ose OVL-në e UÇK-së që të prodhonte të gjitha
23 dokumentet e ZPS-së. Nasim Haradinaj nënshkroi një dokument
24 duke pranuar dorëzimin e këtij dokumenti dhe të dokumentit që
25 ju dorëzuan ZPS-së.

1 Faqja që keni të treguar në ekranet tuaja është një
2 fragment i dokumenteve të sekuestruara nga OVL-ja e UÇK-së me
3 22 shtator 2020. Siç mund ta shikoni, të nderuar Gjykatës, nga
4 kjo faqe dhe faqe të tjera që u janë vënë në dispozicion,
5 dokumenti përmban shënjime të qarta me formulimin me fjalën
6 "konfidencial", "confidential" në anglisht, në fillim dhe në
7 fund të faqes si dhe "produkt i brendshëm pune" dhe gjithashtu
8 edhe logon e ZPS-së.

9 Veprimet e të akuzuarit nuk përfunduan me konferencën për
10 shtyp dhe me dorëzimin e dokumenteve. Ashtu siç kishin bërë
11 edhe më parë, të akuzuarit vijuan që të shfaqeshin programe të
12 ndryshme televizive dhe secila prej këtyre paraqitjeve
13 televizive përmbante dëshmi dhe prova të cilat lidheshin me
14 veprimet dhe synimet e të akuzuarit.

15 Dua t'ju tërheq vëmendjen në disa prej deklaratave të
16 bëra nga të akuzuarit në këto programe televizive pas
17 konferencës për shtyp të 22 shtatorit. Gjatë një programi
18 televizivi më 22 shtator, zoti Haradinaj konfirmoi që ai dhe i
19 bashkë-akuzuari tjetër, kishin shpërndarë informacione nga një
20 grup i tretë dokumentesh të marra më herët atë mëngjes.

21 Ju lutem shikoni fragmentin e transmetuar tani.

22 [Shfaqet video]

23 Z. PACE: [Përkthim] "Ne ua kemi dhënë ju. Ju i keni
24 arkivuar ato si keni dasht". Pra zoti Haradinaj këtu pranon
25 dhënien e dokumenteve për shtypin. Për më tepër thotë që

1 shtypit duhet të ndihet -- duhet t'i vijë turp në qoftë se nuk
2 ka marrë sa dokumente ka dashur nga OVL-ja e UÇK-së. Pra ky
3 është një fragment i marrë nga dokumenti 145.

4 Në shumë programe televizive, pas konferencës së tretë,
5 zoti Gucati e bëri të qartë sërish që objektivat e tij dhe ato
6 të OVL-së së UÇK-së ishin që të pengonin këtë Gjykatë dhe se
7 ata kishin synim që të vazhdonin që ta bënin këtë gjë dhe të
8 vazhdonin të botonin materialet të cilat u ishin dhënë atyre.

9 "Unë shpresoj që kjo Gjykatë të shpërbëhet sa më shpejt
10 të jetë mundur dhe që ata të ndalojnë të gjitha aktivitetet
11 kundër anëtarëve, pjesëtarëve të UÇK-së".

12 Nuk ka asnjë dyshim rreth synimit të zotit Gucati edhe
13 nga një emision i transmetuar më 22 shtator të vitit 2020 dhe
14 kjo është pjesë e dokumentit 141.

15 Në një videoklip tani në një emision tjetër, i cili është
16 transmetuar me 22 shtator, ju do të shikoni se zoti Gucati i
17 përmbahet të njëjtit mesazh.

18 [Shfaqet video]

19 Z. PACE: [Përkthim] "Përgjegjësia është me demantu
20 Gjykatën Speciale".

21 Ky është një fragment tjetër nga i njëjti emision.

22 [Shfaqet video]

23 Z. PACE: [Përkthim] Në këtë fragment ju dëgjoni Hysni
24 Gucatin që edhe një herë të deklarojë qartazi synimet e tij:
25 "Ne do ta smontojmë këtë Gjykatë të Specializuar".

1 Dhe ndërkohë në klipin tjetër ju do të dëgjoni që zoti
2 Gucati do të përsërisë atë çfarë ka thënë i akuzuari tjetër më
3 parë, që ai është i gatshëm që të shkojë në burg për veprimet
4 e tij.

5 [Shfaqet video]

6 Z. PACE: [Përkthim] "Edhe në qoftë se do të më japin pesë
7 vjet në burg, unë jam i gatshëm që t'i përgjigjem thirrjes së
8 Gjykatës Speciale rreth botimit të dosjeve".

9 Këtë tha zoti Gucati në këto tre fragmente nga dokumenti
10 139.

11 Ndërkohë, klipi i fundit i videos që do t'ju përmend dhe
12 do t'ju shfaq është ai i dokumentit 81 i cili jep zotin
13 Haradinaj me datë 25 shtator 2020, pak para se sa ai të
14 arrestohej. Në këtë klip zoti Haradinaj thotë që vendosmëria e
15 tij në këtë fazë nuk është se ishte zbehur aspak.

16 [Shfaqet video]

17 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë te fragmenti tjetër.

18 [Shfaqet video]

19 Z. PACE: [Përkthim] "Ne do të punojmë kundër kësaj
20 Gjykate. Falë zotit, ai që na ka sjellë këto dokumente, do na
21 sjellë më tepër. Ne do t'ja bëjmë këto dokumente të njohura
22 medias". Këtë tha në përmbledhje zoti Haradinaj, pak momente
23 përpara se arrestohej. Kaq i vendosur ishte zoti Haradinaj dhe
24 i akuzuari tjetër aq sa ishin të vendosur që të thyenin dhe të
25 shkelnin ligjin.

1 Ky model i sjelljes kriminale nga dy të akuzuarit që ka
2 filluar me 7 shtator të vitit 2020 përfundoi vetëm me 25
3 shtator të vitit 2020, kur ata u arrestuan dhe më pas u sollën
4 në objektin e paraburgimit. Provat tregojnë që efektet e
5 sjelljes së tyre penale kanë tejkaluar arrestimin e tyre.
6 Rëndësia e kërcënimeve që janë bërë kundër dëshmitarëve,
7 dëshmitarëve potencialë që bashkëpunojnë, nga ZPS-ja tregohen
8 përmes provave me video në këtë çështje, disa pre të cilave u
9 bënë të njohura edhe sot.

10 Në veçanti, provat i tregojnë të akuzuarit në mënyrë të
11 vazhdueshme duke afirmuar dhe duke thënë publikisht dhe në
12 mënyrë të përsëritur që informacioni që lidhej me hetimet
13 konfidenciale do të përdorej për të cenuar punën e Gjykatës.
14 Provat tregonin dëshmitarë potencialë dhe persona që kishin
15 bashkëpunuar me autoritetet hetimore, duke i përshkruar ata si
16 tradhtarë dhe si spiunë dhe duke thënë se asnjë dëshmitar nuk
17 mund të mbrohej më. Këto pohime të tyre në vetvete ishin
18 kërcënime shumë të rënda.

19 Provat po ashtu tregojnë të akuzuarit që shpërndanin pa
20 dallim dokumente, përfshirë të dhëna personale të individëve
21 që kishin bashkëpunuar me TFHS-në dhe ZPS-së, pavarësisht nga
22 veprimet dhe intensiteti i veprimeve të realizuara nga të
23 akuzuarit.

24 Në përmbyllje, siç e kemi dëgjuar gjatë ditës së sotme,
25 ky gjykim ka të bëjë me veprime specifike të ndërmarra nga të

1 akuzuarit, të cilët kanë pasur dhe kanë demonstruar sjellje
2 kriminale për të arritur objektivat e tyre, duke i çuar ata që
3 të kryenin krimet për të cilat akuzohen sot në këtë proces
4 gjyqësor. Provat do të tregojnë që të akuzuarit i kanë kryer
5 krimet për të cilat akuzohen në aktakuzë në mënyrë të
6 përsëritur, me dijeni, qëllimisht dhe me entuziazëm.

7 Pas ofrimit të provave, neve do t'i kërkojmë Trupit
8 Gjykses që të akuzuarit të mbajnë përgjegjësi penale për
9 veprimet e kryera.

10 Faleminderit për vëmendjen.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Këtu përfundon deklarata hyrëse e Prokurorisë dhe fundi i
13 seancës publike sot. Do të rifillojmë në 18 tetor në orën
14 09.30 në mëngjes për të dëgjuar dëshminë e dëshmitarit të parë
15 të ZPS-së.

16 Falënderoj palët dhe Zyrën Administrative për
17 pjesëmarrjen. Gjithashtu falënderoj përkthyesit, stenografët
18 dhe teknikët dhe personelin e sigurisë. Këtu përfundojmë.

19 --- Seanca mbyllet në orën 12.34 pasdite

20

21

22

23

24

25